FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.149 dhjetor 2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9662 datë 18.12.2006	Për bankat në Republikën e Shqipërisë…….	6013

LIGJ
Nr. 9662, datë 18.12.2006

PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është vendosja e kushteve dhe e rregullave për krijimin, licencimin, organizimin, drejtimin, kujdestarinë dhe likuidimin e bankave, ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare, si dhe mbikëqyrjen e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, në përputhje me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë".

2. Subjekte të këtij ligji janë personat që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, sipas përcaktimeve në nenin 4 dhe 54 të këtij ligji, me përjashtim të Bankës së Shqipërisë dhe të subjekteve të tjera, veprimtaria e të cilave rregullohet me ligj të veçantë.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të vendosë me akte nënligjore që subjektet e përmendura në nenin 126, që ushtrojnë veprimtari të përshkruara në nenin 54 të këtij ligji, për shkak të natyrës, vëllimit të veprimtarisë apo të origjinës së burimeve financiare të tyre, të përjashtohen nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji.

Neni 3
Sistemi bankar

Sistemi bankar në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga Banka e Shqipërisë, statusi i së cilës përcaktohet me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", si dhe nga bankat dhe degët e bankave të huaja, statusi i të cilave përcaktohet nëpërmjet këtij ligji.

Neni 4
Përkufizime

I. Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Bankë" është personi juridik me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, që ushtron veprimtari bankare dhe veprimtari të tjera, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. "Veprimtari bankare" është pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet, si dhe emetimi i mjeteve të pagesës në formën e parasë elektronike.

3. "Veprimtari financiare" është çdo lloj veprimtarie që përcaktohet në nenin 54 pika 2 të këtij ligji.

4. "Licencë" është akti administrativ i lëshuar nga Banka e Shqipërisë, me anën e të cilit i jepet e drejta një personi juridik për të kryer veprimtari bankare dhe financiare, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

5. "Depozitë monetare" është:

teprica kreditore, e cila rezulton nga fondet e depozituara në një llogari ose në një nga gjendjet e përkohshme që rrjedhin nga veprimet e zakonshme bankare dhe të cilat banka duhet t'i ripaguajë sipas dispozitave të një kontrate dhe dispozitave ligjore;

çdo detyrim i vërtetuar nëpërmjet një dokumenti apo vërtetimi të lëshuar nga banka ose dega e bankës së huaj.

6. "Kredi" është marrëdhënia juridike e detyrimit për të livruar një shumë monetare në këmbim të së

drejtës së ripagimit të shumës së livruar dhe të interesit ose komisioneve të tjera bankare mbi këto shuma, si dhe çdo shtyrje e datës së maturimit të një letre me vlerë të borxhit apo të ndonjë të drejte tjetër për të paguar një shumë monetare.

7. “Pjesëmarrje” është çdo e drejtë pronësie mbi kapitalin ose çdo aksion me të drejtë vote në personin juridik.

8. “Pjesëmarrje influencuese” është zotërimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i së drejtës së pronësisë të një aksioneri në masën 10 për qind ose më shumë të kapitalit të personit juridik ose të aksioneve të tij me të drejtë vote, ose në një masë të tillë që krijon mundësi të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në drejtimin apo në politikat e këtij personi juridik.

9. “Persona ose grup personash të lidhur” janë:

9. 1. Në rastet kur:

dy ose më shumë persona, të cilët përfaqësojnë një rrezik të vetëm për bankën ose degën e bankës së huaj, për shkak se njëri prej tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ka kontroll mbi tjetrin ose të tjerët; ose

dy ose më shumë persona, të cilët përbëjnë një rrezik të vetëm për bankën ose degën e bankës së huaj, për shkak se njëri prej tyre ushtron, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikim të konsiderueshëm mbi tjetrin ose të tjerët; ose

dy ose më shumë persona, të lidhur mes tyre në një marrëdhënie bashkëkontrollli; ose

ç) dy ose më shumë persona, ndërmjet të cilëve nuk ka marrëdhënie kontrolli ose ndikimi, siç përcaktohet në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, por të cilët mund të përbëjnë një rrezik të vetëm për bankën ose degën e bankës së huaj, për shkak se ata janë të ndërlidhur në mënyrë të tillë që përkeqësimi i situatës financiare të njërit prej tyre mund të sjellë përballjen e tjetrit ose të tjerëve me të njëjtën situatë, për shkak se humbja, fitimi ose aftësia paguese e njërit prej tyre mund të transferohet tek tjetri apo të tjerët; ose

dy apo më shumë persona, të cilët, mbi bazën e një marrëdhënieje juridike, ofrojnë shërbime të specializuara për njëri-tjetrin ose për një person tjetër; ose

dh) administratorët e një personi dhe të afërm të ngushtë të tyre.

9.2. Në rastet e personave me një marrëdhënie të veçantë me bankën, si më poshtë:

a) aksionerët e bankës, të cilët zotërojnë 5 për qind ose më shumë të kapitalit apo të aksioneve me të drejtë vote në asamblenë e aksionerëve të një banke; ose

b) administratorët apo përfaqësuesit e bankës; ose

c) personat, të cilët kanë lidhur kontrata pune me bankën nën kushte të veçanta; ose

ç) të afërm të ngushtë të personave të parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike; ose

d) personat juridikë, në kapitalin e të cilëve personat e parashikuar në shkronjat “a” deri në “ç” të kësaj pike zotërojnë më shumë se 20 për qind të kapitalit ose të aksioneve me të drejtë vote;

ose

dh) personat juridikë, në kapitalin e të cilëve banka zotëron më shumë se 20 për qind të kapitalit ose të aksioneve me të drejtë vote, apo që i kontrollon këta persona juridikë në një mënyrë tjetër.

10. “Të afërm të ngushtë të një personi” janë:

a) fëmijët (ose të birësuarit);

b) fëmijët e fëmijëve;

c) bashkëshorti/ja;

ç) prindërit;

d) vëllezërit, motrat, si dhe fëmijët e tyre;

dh) personat në kujdestarinë e tij.

11) “Kontroll” është marrëdhënia, në të cilën një person që:

zotëron, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shumicën e aksioneve apo të votave të një personi juridik; ose

i vetëm zotëron shumicën e votave të një personi juridik, në bazë të një marrëveshjeje me ortakët apo me aksionerët e tjerë; ose

përcakton de facto vendimet e marra nga personi juridik; ose

ç) kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së administratorëve të personit juridik.

12. “Filial” është një shoqëri, e cila zotërohet në më shumë se gjysmën e kapitalit nga një shoqëri tjetër. Të gjitha filialet e filialit janë filiale të personit juridik që ushtron kontroll mbi këtë filial.

13. “Shoqëri të bashkëkontrolluara” janë dy ose më shumë filiale të një personi juridik, i cili ushtron kontroll të drejtpërdrejtë mbi to.

14. “Degë e bankës” është njësia organizative në varësinë e bankës, e cila ushtron në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha apo disa nga veprimtaritë që ushtron banka, në emër dhe për llogari të kësaj të fundit.

15. “Degë e bankës së huaj” është dega e një banke të licencuar për të kryer veprimtari bankare nga autoriteti përgjegjës i një vendi tjetër, të ndryshëm nga Republika e Shqipërisë. Kjo degë licencohet nga Banka e

Shqipërisë dhe regjistrohet në regjistrin e shoqërive tregtare.

16. “Agjenci bankare” është njësia organizative e bankës, nën varësinë e degës së bankës, e cila ushtron drejtpërsëdrejti një ose disa veprimtari bankare dhe financiare në emër dhe për llogari të bankës.

17. “Zyrë përfaqësimi e bankës” është njësia organizative e bankës, e cila vepron në një shtet tjetër, të ndryshëm nga Republika e Shqipërisë, me qëllim studimin e tregut dhe të kërkesave të publikut për produkte bankare në atë vend. Ajo nuk ushtron veprimtari bankare dhe financiare.

18. “Aksione me të drejtë vote” janë aksionet e zakonshme në kapitalin e emetuesit, si dhe çdo aksion tjetër, të cilat gëzojnë të drejtën e votës për çdo iniciativë vendimmarrëse në asamblenë e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të emetuesit.

19. “Administrator i bankës ose i degës së bankës së huaj” është individi, i cili është:

anëtar i këshillit drejtues ose i komitetit të kontrollit të bankës; ose

b) drejtues ekzekutiv; ose

c) drejtues i njësisë së kontrollit.

20. “Drejtues ekzekutiv” është individi në marrëdhënie pune me kohë të plotë në funksione drejtuese, ekzekutive ose administrimi në bankë apo në degën e bankës së huaj.

21. “Person” është individi, personi fizik, personi juridik dhe personat juridikë të lidhur.

22. “Klient” është personi, i cili është përdorues i shërbimeve bankare dhe financiare.

23. “Kapital fillestar minimal” është shuma minimale e kapitalit në para, e kërkuar për marrjen e licencës, për të ushtruar veprimtarinë bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

24. “Kapital fillestar i paguar” është kapitali që kanë paguar aksionerët e bankës për të filluar veprimtarinë bankare.

25. “Kapital fillestar minimal i dhuruar” është shuma e dhuruar dhe e paguar nga banka e huaj e kapitalit fillestar minimal për hapjen e një dege të saj në territorin e Republikës së Shqipërisë.

26. “Kapital rregullator” është kapitali i llogaritur për qëllime të mbikëqyrjes bankare, ku përfshihen kategoritë e ndryshme të kapitalit dhe të rezervave, si dhe elemente të tjera, të cilat përcaktohen nga Banka e Shqipërisë me akte nënligjore.

27. “Mjaftueshmëria e kapitalit” është raporti ndërmjet kapitalit rregullator të bankës me shumën e zërave të aktivit të bilancit dhe të zërave jashtë bilancit, të ponderuara me rrezikun.

28. “Shpërndarje e kapitalit” është:

çdo shpërblim ndaj aksionerit për kapitalin e investuar në mjete fizike monetare ose në çdo pasuri tjetër nga banka, sipas parashikimit në kontratë (përqindje mbi kapitalin e investuar apo shpërblim në formë pagash që nuk rëndon rezultatin financiar të bankës);

çdo likuidim i pjesshëm (ndryshimi i raporteve në pjesëmarrje midis aksionerëve) ose i plotë (largimi i aksionerit nga pjesëmarrja në bankë) i aksionerit.

29. “Aksioner i drejtpërdrejtë i bankës” është personi që ka pjesëmarrje në kapitalin e bankës.

30. “Aksioner i tërthortë i bankës” është personi që ka pjesëmarrje në kapitalin e një personi juridik, që është aksioner i drejtpërdrejtë në kapitalin e bankës.

31. “Subjekt financiar jobankë” është personi juridik që licencohet nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar një ose disa nga veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 54 pika 2 të këtij ligji. Subjekti financiar jobankë ndalohet të grumbullojë depozita monetare dhe fonde të tjera të ripagueshme nga publiku.

32. “Rrezik” është mundësia e humbjes financiare, si rezultat i ndodhjes së një ngjarjeje të pritshme.

33. “Administrimi i rrezikut” është tërësia e metodave dhe e rregullave që përdoren nga banka ose dega e bankës së huaj për identifikimin, monitorimin dhe administrimin e rreziqeve, me qëllim shmangien e humbjeve financiare.

34. “Shkelje me pasoja të rënda” janë veprime ose mosveprime, prej të cilave bankës ose degës së bankës së huaj i janë shkaktuar humbje të ndjeshme financiare apo kanë sjellë paaftësi paguese, si dhe të cilat vënë në rrezik qëndrueshmërinë dhe sigurinë e veprimtarisë së bankës ose degës së bankës së huaj, apo shkatojnë shtrembërimin ose mosparaqitjen e plotë të pasqyrave financiare të saj.

35. “Komision” është pagesa e kryer nga banka ose dega e bankës së huaj për marrjen dhe vlefshmërinë e licencës, në zbatim të nenit 27 të këtij ligji.

36. “Kujdestari” është procesi i vendosjes së bankës në administrim dhe në kontroll të kujdestarit të zgjedhur dhe të emëruar nga Banka e Shqipërisë, në rast të evidentimit të rrethanave të parashikuara në nenin 96 të këtij ligji.

37. “Kujdestar” është individi i zgjedhur dhe i emëruar nga Banka e Shqipërisë për të marrë në kujdestari bankën, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

38. “Likuidim i detyruar” është procesi i vendosjes së bankës ose degës së bankës së huaj në posedim dhe në kontroll të likuidatorit të zgjedhur dhe të emëruar nga Banka e Shqipërisë, në rast të evidentimit të rrethanave të parashikuara në nenin 108 të këtij ligji.

39. “Likuidim vullnetar” është prishja e bankës ose e degës së bankës së huaj me vullnetin e

aksionerëve të bankës apo bankës së huaj për degën e saj dhe sipas kushteve të parashikuara në nenin 107 të këtij ligj.

40. “Likuidator” është individi i zgjedhur dhe i emëruar nga Banka e Shqipërisë për të likuiduar bankën ose degën e bankës së huaj gjatë procesit të likuidimit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

41. “Grup bankar” është:

a) një grup, në të cilin një bankë me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, që ka pjesëmarrje influencuese ose kontrollon një apo më shumë banka ose institucione të tjera financiare me seli brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; ose

b) një grup, në të cilin një subjekt financiar jobankë, i licencuar nga Banka e Shqipërisë, ka pjesëmarrje influencuese ose kontrollon një bankë me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kur totali i bilancit të kësaj banke është më i madh se secili prej investimeve të tjera të kryera nga ky subjekt financiar jobankë.

42. “Shoqëri financiare zotëruese” është personi juridik, i cili:

a) ka si veprimtari kryesore blerjen ose mbajtjen e pronësisë së pjesëmarrjeve influencuese apo ofrimin e shërbimeve të tjera financiare;

b) ka pjesëmarrje influencuese ose kontrollon një bankë apo institucione të tjera financiare;

c) nuk ushtron drejtpërdrejt veprimtari bankare.

43. “Bankë mbizotëruese në një grup bankar ose financiar” është:

a) banka që ka pjesëmarrjen influencuese ose kontrollin mbi institucionet e tjera që përbëjnë grupin;

b) banka, në kapitalin e së cilës një subjekt financiar jobankë, pjesëtar i grupit, ka pjesëmarrje influencuese ose ushtron kontroll, kur totali i bilancit të bankës është i njëjtë ose më i madh se secili prej investimeve të tjera të kryera nga ky subjekt financiar jobankë.

44. “Regjistri i Kredive” është baza e të dhënave, e krijuar me qëllim të trajtimit të informacionit të raportuar nga bankat dhe degët e bankave të huaja apo nga subjekte të tjera të këtij ligji, kur përcaktohet me akt nënligjor nga Banka e Shqipërisë dhe të shpërndarjes së këtij informacioni, sipas nenit 127 të këtij ligji.

45. “Agjencia e Sigurimit të Depozitave” është agjencia e krijuar me ligjin nr. 8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”.

II. Titujt dhe krerët në këtë ligj janë përdorur vetëm për orientim e referim dhe nuk kanë për qëllim të kushtëzojnë ose të kufizojnë interpretimin e përcaktimeve dhe të dispozitave të këtij ligji.

III. Në këtë ligj, fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjelltas, kurdoherë që një gjë e tillë është e domosdoshme nga përmbajtja e dispozitës.

IV. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe gjininë femërore dhe anasjelltas.

Neni 5

E drejta për të ushtruar veprimtari bankare

Veprimtaria bankare në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nga:

banka me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe e licencuar nga Banka e Shqipërisë;

dega e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 6

Ndalimet në ushtrimin e veprimtarisë bankare

Asnjë subjekt, përveç atyre të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, nuk lejohet të ushtrojë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.

Asnjë subjekt nuk lejohet të ushtrojë veprimtari bankare në territorin e Republikës së Shqipërisë pa licencë të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Asnjë subjekt i licencuar nga Banka e Shqipërisë nuk mund të ushtrojë veprimtari bankare jashtë atyre të përcaktuara në aneksin e licencës.

Asnjë subjekt nuk mund të përdorë fjalën “bankë”ose fjalë të prejardhura prej saj në ushtrimin e veprimtarisë tregtare ose në veprime promocionale, pa licencë të lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Përjashtim bëjnë rastet kur parashikohet ndryshe në ligj ose në marrëveshjet ndërkombëtare, apo kur bëhet e qartë nga përmbajtja se fjala “bankë” ose fjalë të prejardhura prej saj nuk kanë lidhje me veprimtarinë bankare.

Asnjë subjekt, emri i të cilit lidhet me fjalën “bankë” dhe fjalë të prejardhura prej saj, i cili nuk ka marrë miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, nuk mund të regjistrohet në regjistrin e shoqërive tregtare.

Neni 7

Gjuha

Të gjitha subjektet e këtij ligji përdorin gjuhën shqipe në dokumentacionin dhe korrespondencën që mbajnë në Republikën e Shqipërisë.

Fjalët “bankë” ose “degë” janë pjesë përbërëse të bankës ose të degës së bankës së huaj dhe shprehen në gjuhën shqipe.

Neni 8
Informimi për gjendjen e sistemit bankar dhe të atij financiar

Banka e Shqipërisë, në deklaratën periodike që dërgon në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave, sipas kërkesës së ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, informon gjithashtu edhe për situatën dhe zhvillimet më të fundit në sistemin bankar dhe financiar, si edhe rekomandon përmirësimet e nevojshme në kuadrin ligjor dhe institucional të këtij sistemi.

Neni 9
Parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit

Subjektet e këtij ligji dhe Banka e Shqipërisë zbatojnë kërkesat që rrjedhin nga ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave” dhe nga ligji “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, si dhe nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

Neni 10
Forma juridike e bankës

Banka themelohet si shoqëri anonime me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin “Për shoqëritë tregtare”, përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

Banka mund të themelohet edhe me kapital shtetëror, sipas dispozitave të këtij ligji ose me ligj të veçantë.

Dega e bankës së huaj regjistrohet sipas dispozitave të parashikuara në ligjin “Për regjistrin zyrtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”.

Neni 11
Shtrirja e rrjetit bankar

1. Banka ka të drejtë të hapë degë ose agjenci bankare brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe zyra përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Banka e huaj ka të drejtë të hapë një ose disa degë apo agjenci bankare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për të cilat Banka e Shqipërisë lëshon një licencë të vetme. Këto degë, për qëllime të mbikëqyrjes, konsiderohen si një e vetme.

Neni 12
Kapitali aksioner i bankës

Aksionet e kapitalit të një banke janë vetëm të llojit nominativ.

Në çdo rast aksionet parapaguhen në para.

Banka nuk mund t’i japë kredi apo t’i lëshojë garanci, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, një personi për blerjen e aksioneve të saj ose të aksioneve të një shoqërie, në të cilën banka zotëron 20 për qind ose më shumë të kapitalit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Për qëllim të licencimit, banka përmbush të gjitha kërkesat në lidhje me kapitalin, të cilat përcaktohen në kreun II të këtij ligji.

Neni 13
Burimi i kapitalit

1. Çdo aksioner i një banke jep informacion për burimet e kapitalit fillestar të paguar prej tij për krijimin e bankës, si dhe për çdo shtesë të kapitalit gjatë zhvillimit të veprimtarisë, sipas kritereve të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë.

2. Çdo pagesë e kapitalit fillestar dhe çdo shtesë e mëvonshme e tij shoqërohen me paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të informacionit lidhur me burimin e krijimit të këtij kapitali, si më poshtë:

për personat juridikë paraqitet:

i) evidenca e burimit të krijimit të fondeve, e paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, bilanci kontabël vjetor, dhurata ose burime të tjera të destinuara për blerjen e aksioneve të bankës);

ii) certifikata e autoriteteve kompetente, që siguron të dhëna për bilancin e shoqërisë dhe rregullshmërinë e pagesës së tatimeve dhe taksave;

për individët paraqitet:

i) evidenca e burimit të fondeve, e paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka ose të tjera evidenca të burimit të fondeve);

ii) certifikata e autoriteteve përkatëse shtetërore, lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore.

3. Mënyrat dhe procedurat e paraqitjes së dokumentacionit përcaktohen nga Banka e Shqipërisë me akt nënligjor.

KREU II
LICENCIMI I BANKAVE DHE I DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA

Neni 14
Autoriteti licencues

Banka e Shqipërisë është autoriteti i vetëm përgjegjës për licencimin e bankave dhe të degëve të bankave të huaja për të ushtruar veprimtari bankare dhe veprimtari të tjera financiare, në përputhje me këtë ligj.

E drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë bankare dhe financiare lind vetëm pasi banka dhe dega e bankës së huaj pajisen me licencë nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë kërkon informacion nga çdo person, nëse nga rrethanat e faktit konkludon se personi ushtron veprimtari bankare dhe financiare pa licencë, si dhe u kërkon institucioneve kompetente ndalimin e veprimtarive të mësipërme dhe marrjen e masave përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi. Në rastin e mësipërm, personi është i detyruar t'i japë Bankës së Shqipërisë të gjithë informacionin e kërkuar prej saj.

Neni 15
Karakteristikat e licencës

Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.

Licenca ka si pjesë përbërëse të saj aneksin e veprimtarive bankare dhe veprimtarive financiare, për të cilat banka dhe dega e bankës së huaj licencohet, me plotësimin e kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 16
Fazat e licencimit

Licencimi i bankës dhe i degës së bankës së huaj kalon në dy faza:

miratimi paraprak i licencës; dhe

dhënia e licencës.

Neni 17
Kërkesa në lidhje me dokumentacionin

1. Kërkesa për licencimin si bankë bëhet me shkrim nga aksionerët themelues të bankës së propozuar, paraqitet në Bankën Shqipërisë në formën e përcaktuar në aktin nënligjor të saj dhe shoqërohet me:

a) aktin e themelimit dhe projektstatutin;

b) emrin e propozuar;

c) adresën e selisë;

ç) shumën e kapitalit aksioner të nënshkruar të bankës dhe dokumentacionin që vërteton burimin e ligjshëm të kontributeve në kapital;

d) dokumentacionin ose të dhënat zyrtare nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatim-taksave nga aksionerët e propozuar;

dh) informacionin për kualifikimin, reputacionin dhe përvojën në drejtimin e një banke ose të një sipërmarrjeje me madhësi të ngjashme dhe të dhëna për ecurinë e veprimtarisë së saj, për të paktën dy prej administratorëve që do të drejtojnë efektivisht bankën e propozuar. Administratorët e propozuar e shoqërojnë këtë informacion me një deklaratë që asnjë nga faktorët skualifikues të nenit 41 të këtij ligji nuk vërtetohet tek administratorët e ardhshëm;

e) planin e biznesit për tre vitet e para të veprimtarisë, i cili duhet të përmbajë, midis të tjerave:

i) strukturën organizative;

ii) llojet e veprimtarive bankare dhe financiare që do të kryejë;

iii) deklaratat financiare të parashikuara;

iv) parimet, në bazë të të cilave është përgatitur plani i biznesit; dhe

v) madhësinë dhe natyrën e veprimtarisë së bankës së propozuar dhe pozicionin e saj në tregun financiar;

ë) emrin, vendbanimin, vendqëndrimin ose selinë, informacion mbi reputacionin dhe të dhëna për veprimtarinë tregtare apo profesionale për shtatë vjetët e fundit të çdo personi që propozon të zotërojë pjesëmarrje influencuese, si dhe shumën e propozuar. Për qëllimin e kësaj dispozite, pjesëmarrja e propozuar nga personat e lidhur mblidhet për të përcaktuar shumën e pronësisë së propozuar për disponim;

f) të gjitha pjesëmarrjet e drejtpërdrejta ose të tërthorta në kapitalin e bankës në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind, deri në përfituesin e fundit, si dhe të drejtat e votës që ekzistojnë për zotëruesit e këtyre pjesëmarrjeve;

g) strukturën e kapitalit, duke përcaktuar të drejtat e votës ose të drejtat mbi kapital të aksionerëve;

gj) informacion për çdo marrëveshje ose çdo formë tjetër rregullimi, nëpërmjet së cilës kontrolli apo ndikimi në vendimmarrje mund të ushtrohet në çdo mënyrë tjetër;

h) llogaritë dhe raporti vjetor i personit juridik, llogaritë dhe raporti vjetor i konsoliduar, si dhe opinioni i ekspertit kontabël të autorizuar për auditimin e llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara gjatë tre vjetëve të fundit.

2. Kërkesa për licencimin e degës së bankës së huaj bëhet me shkrim nga organet vendimmarrëse të bankës së huaj, paraqitet në Bankën e Shqipërisë në formën e përcaktuar me akt nënligjor prej saj dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

lejen e ushtrimit të veprimtarisë bankare, të dhënë nga autoritetet përkatëse në vendin ku ndodhet selia e saj, si dhe listën e veprimtarive, për të cilat është licencuar banka e huaj;

b) dokumentin përkatës, i cili vërteton regjistrimin si person juridik të bankës së huaj;

c) statutin e bankës së huaj, duke përfshirë të dhënat për adresën e saktë të selisë, përshkrimin e veprimtarisë, shumën e kapitalit, strukturat e drejtimit të bankës dhe administratorët e saj;

ç) informacionin në lidhje me adresën në të cilën do të vendoset dega;

d) strukturën e pronësisë së bankës së huaj;

dh) llogaritë dhe raportin vjetor të bankës së huaj, llogaritë dhe raportin vjetor të konsoliduar, si dhe opinionin e ekspertit kontabël të autorizuar për auditimin e llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara gjatë tre vjetëve të fundit;

e) emrin e autoritetit mbikëqyrës dhe pëlqimin e tij për hapjen e degës së bankës së huaj, si dhe informacion për zbatimin e parimeve dhe teknikave të mbikëqyrjes së konsoliduar;

ë) shumën e dhuruar të kapitalit fillestar minimal, sipas përcaktimit nga Banka e Shqipërisë në aktet nënligjore të saj;

f) informacionin për skemën e sigurimit të depozitave monetare, sipas legjislacionit përkatës;

g) dokumentacionin e përcaktuar në shkronjat “dh” dhe “e” të pikës 1 të këtij neni.

3. Një bankë e huaj mund të propozojë të zotërojë pjesëmarrje influencuese në një bankë nëse ajo është e autorizuar nga autoritetet përkatëse të kryejë veprime të pranimit dhe të grumbullimit të depozitave në para ose fonde të tjera të ripagueshme në vendin e huaj, ku ajo ka selinë. Autoritetet e huaja, që mbikëqyrin veprimtaritë bankare të bankës së huaj, japin pëlqimin e tyre me shkrim për këtë zotërim.

4. Kërkesa për miratimin e zyrës së përfaqësimit të një banke të huaj bëhet nga banka e huaj. Kjo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar nga shkronja “a” deri në shkronjën “dh” të pikës 2 të këtij neni.

5. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë informacione të tjera shtesë me akt nënligjor, përveç sa parashikohet në këtë nen.

6. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të bëjë verifikime të pavarura për të provuar vërtetësinë e informacionit të ofruar nga personi që kërkon të licencohet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë bashkëpunon me organet përgjegjëse vendase dhe me autoritetet e huaja mbikëqyrëse.

Neni 18

Kërkesa për kapitalin

Banka ose dega e bankës së huaj, për t’u licencuar, duhet të derdhë një kapital fillestar minimal. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor shumën e kapitalit fillestar minimal, të derdhur në para, për të kryer veprimtari bankare dhe ndryshimin e kësaj shume nga njëra periudhë në tjetrën.

Kapitali fillestar minimal për të marrë licencën për të kryer veprimtari bankare depozitohet në Bankën e Shqipërisë në një llogari depozitë, e marrë si garanci pa interes dhe bllokohet deri në marrjen e licencës. Depozitimi bëhet me xhirim në llogari.

Kapitali fillestar minimal nuk mund të përbëhet nga hua nga publiku, kredi nga banka dhe paradhënie nga subjekte dhe palë të treta.

Neni 19

Miratimi pararak i licencës ose refuzimi i saj

1. Banka e Shqipërisë, brenda 3 muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë, jep ose refuzon miratimin paraprak për licencë dhe njofton me shkrim kërkuesin për vendimin e saj. Në kuptim të këtij paragrafi, datë e pranimit të kërkesës për licencë është data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për licencë vetëm kur krijon bindjen se:

a) banka ose dega e bankës së huaj i përmbahet kërkesave të këtij ligji;

b) aksionerët e bankës kanë reputacion të mirë, burim të ligjshëm të kontributeve në kapital, veprimtari të ligjshme të regjistruar dhe të kontrolluar, kanë mundësi financiare për derdhjen e fondeve shtesë në qoftë se kapitali bie nën nivelin minimal të kërkuar nga Banka e Shqipërisë ose për realizimin e financimeve të nevojshme për vazhdimin e veprimtarisë së bankës;

c) kualifikimet, përvoja e reputacioni i administratorëve të bankës dhe i degës së bankës së huaj, si dhe i aksionerëve me pjesëmarrje influencuese janë të përshtatshme për realizimin e planit të biznesit, në bazë të të cilit ato licencohen;

ç) çdo aksioner zotëron pronësinë e jo më shumë se 1/3 të kapitalit ose të aksioneve me të drejtë vote të bankës. Përjashtim bëjnë rastet kur një bankë e huaj krijon një degë, një filial ose fiton pronësinë mbi aksionet e një banke;

d) strukturat operacionale dhe të kontrollit, përfshirë politikat dhe procedurat e bankës dhe të degës së bankës së huaj, reflektojnë qëllimin dhe shkallën e plotësimit të veprimtarive të propozuara të tyre;

dh) plani i biznesit i paraqitur është real dhe konkurrues në treg dhe gjendja e pritshme financiare e bankës ose e degës së bankës së huaj të propozuar është e kënaqshme;

e) banka e huaj, që kërkon licencë për të hapur një degë, është e mbikëqyrur në baza të konsoliduara dhe në baza të qëndrueshme nga autoritete të huaja mbikëqyrëse;

ë) banka ose dega e bankës së huaj ka jo më pak se dy drejtues ekzekutivë.

3. Banka e Shqipërisë refuzon miratimin paraprak të licencës për bankën ose degën e bankës së huaj kur:

nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni;

të paktën njëri nga administratorët ose aksionerët me pjesëmarrje influencuese ka qenë subjekt i procedurave të falimentimit;

nuk paraqitet informacion lidhur me identitetin e aksionerëve me pjesëmarrje influencuese;

ç) vërtetohet se të paktën njëri nga aksionerët e saj:

i) është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore;

ii) kur ndaj tij është marrë vendimi nga gjykata për moslejimin e ushtrimit të veprimtarisë;

iii) është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me pastrimin e parave ose me financimin e terrorizimit;

nuk plotësohet informacioni shtesë i kërkuar nga Banka e Shqipërisë, sipas nenit 17 pika 5 të këtij ligji;

dh) nuk posedon shumën e kapitalit fillestar minimal të kërkuar nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare.

4. Banka e Shqipërisë, në rastin e refuzimit të miratimit paraprak për licencë, shpjegon arsyet në vendimin përkatës.

5. Në vendimin e miratimit paraprak për licencë, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të përcaktojë kushte të tjera shtesë që duhet të plotësojë banka ose dega e bankës së huaj për të marrë licencën dhe për të filluar veprimtarinë e saj, përveç atyre që janë parashikuar në nenin 20 të këtij ligji.

6. Banka e Shqipërisë ndërpret shqyrtimin e dokumentacionit për dhënien e miratimit paraprak për licencë në qoftë se kërkuesi, brenda 12 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës, nuk ka plotësuar dokumentacionin sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

Neni 20

Licenca

1. Për marrjen e licencës, banka ose dega e bankës së huaj që ka marrë miratimin paraprak për licencë, brenda 12 muajve pas marrjes së këtij miratimi, plotëson kushtet e mëposhtme:

bën regjistrimin e saj si person juridik në gjykatë, shoqëruar me aktin e themelimit dhe statutin në rastin e bankës, i cili miratohet nga Banka e Shqipërisë;

kryen pagesën e kapitalit fillestar minimal nga aksionerët e bankës ose bën transferimin e shumës së dhuruar të kapitalit fillestar minimal të degës së bankës së huaj, me qëllim të fillimit të veprimtarisë;

punëson administratorët;

ç) blen ose merr me qira lokalet ku do të ushtrohet veprimtaria bankare dhe financiare;

emëron ekspertin kontabël të autorizuar, në përputhje me nenin 48 të këtij ligji;

dh) bën sigurimin dhe mbrojtjen e lokaleve dhe pajisjeve për kryerjen e veprimtarisë;

harton procedura administrative dhe të kontabilitetit dhe mekanizma të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm;

ë) krijon kushte teknike dhe organizative për të kryer veprimtari bankare dhe financiare;

vërteton paraqitjen e kërkesës dhe të dokumentacionit të plotë në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për marrjen e certifikatës së sigurimit të depozitave, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Banka e Shqipërisë jep licencën për të filluar veprimtarinë bankare dhe financiare në rast se plotësohen kushtet e pikës 1 të këtij neni dhe kushtet e tjera shtesë, sipas nenit 19 pika 5 e këtij ligji.

3. Banka e Shqipërisë, në çdo kohë, përpara miratimit të licencës, ka të drejtë të përcaktojë kërkesa dhe kushte shtesë për marrjen e licencës.

4. Banka e Shqipërisë verifikon plotësimin e kushteve për fillimin e veprimtarisë bankare dhe financiare dhe merr vendimin për dhënien ose refuzimin e licencës.

5. Banka e Shqipërisë nuk mund të licencojë asnjë bankë ose degë banke të huaj për të ushtruar veprimtari bankare, që nuk posedon shumën e kapitalit fillestar minimal të derdhur në para, të përcaktuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.

6. Banka e Shqipërisë shfuqizon miratimin paraprak për licencë, në rast se banka ose dega e bankës së huaj, brenda 12 muajve nga marrja e këtij miratimi, nuk i plotëson kushtet për marrjen e licencës për fillimin e veprimtarisë së saj. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të zgjasë këtë afat jo më tepër se 6 muaj nga data e përfundimit të tij.

7. Banka ose dega e bankës së huaj e licencuar njofton me shkrim Bankën e Shqipërisë dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për datën e fillimit të veprimtarisë. Banka ose dega e bankës së huaj fillon veprimtarinë jo më vonë se 6 muaj pas marrjes së licencës.

Neni 21

Publikimi dhe botimi i vendimit për dhënien e licencës

Banka e Shqipërisë publikon vendimin për dhënien e licencës.

Vendimi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe në një ose më shumë gazeta kombëtare.

Neni 22

Kushti i sigurimit të depozitave monetare

Bankat dhe degët e bankave të huaja nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë bankare pa realizuar sigurimin e depozitave monetare, sipas dispozitave të ligjit “Për sigurimin e depozitave”.

Neni 23

Veprimtaritë shtesë

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, banka ose dega e bankës së huaj ka të drejtë t'i kërkojë Bankës së Shqipërisë të lejohet të kryejë veprimtari të tjera, të papërfshira në aneksin e licencës se dhënë, sipas nenit 20 të këtij ligji.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, dega e bankës së huaj nuk mund të kryejë veprimtari, për të cilat nuk është licencuar vetë banka e huaj.

3. Banka e Shqipërisë jep miratimin për kryerjen e veprimtarive shtesë, nëse vlerëson që këto veprimtari nuk vënë në rrezik qëndrueshmërinë financiare të bankës ose të degës së bankës së huaj dhe janë plotësuar kushtet administrative dhe teknike të nevojshme për kryerjen e tyre në mënyrë të sigurt.

4. Në rastin e refuzimit të kërkesës, Banka e Shqipërisë jep me shkrim arsyet e këtij refuzimi.

Neni 24

Miratime paraprake

1. Banka, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë, nuk mund:

të ndryshojë emrin;

të ndryshojë statutin;

të përfundojë me të tretët marrëveshje për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive për administrimin dhe drejtimin e bankës. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kriteret për lidhjen e marrëveshjeve të mësipërme, si dhe funksionet dhe përgjegjësitë, ushtrimi i të cilave nuk mund t'u delegohet të tretëve nëpërmjet marrëveshjeve;

ç) të ushtrojë veprimtari financiare të papërfshira në aneksin e licencës së dhënë;

të zmadhojë kapitalin me mjete jolikuide;

dh) të riblejë aksionet e saj ose të personave të lidhur me të, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një personi tjetër, duke dhënë kredi ose duke lëshuar garanci;

të zvogëlojë kapitalin;

ë) të emërojë një ose disa administratorë;

të hapë një degë, filial ose zyrë përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

të investojë mbi 15 për qind të kapitalit të saj rregullator në kapitalin e një personi juridik që nuk ushtron veprimtari bankare;

gj) të transferojë pronësinë e një aksioneri me pjesëmarrje influencuese ose kontrollin e bankës te një palë e tretë;

të rrisë përqindjen e një aksioneri me pjesëmarrje influencuese, duke tejkaluar 20, 33 ose 50 për qind të kapitalit të bankës ose të të drejtave të votës apo në një masë të tillë që banka të bëhet filial i tij;

të shpërndajë kapitalin;

të hapë degë dhe agjenci brenda territorrit të Republikës së Shqipërisë.

2. Dega e bankës së huaj merr miratim paraprak nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimeve të mëposhtme:

a) ushtrimin e veprimtarive financiare të papërfshira në aneksin e licencës së dhënë;

b) emërimin e një ose disa administratorëve;

c) hapjen e degëve dhe agjencive brenda territorrit të Republikës së Shqipërisë.

3. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon miratimin paraprak, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, brenda tre muajve nga paraqitja e plotë e kërkesës, mbështetur në dokumentacionin e përcaktuar me akt nënligjor.

4. Banka ose dega e bankës së huaj kërkon miratimin me vendim gjyqësor ose kryen regjistrimin në regjistrin tregtar, sipas rastit, të fakteve juridike që rrjedhin nga realizimi i veprimtarive në zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe për të cilat nevojitet miratimi paraprak i Bankës së Shqipërisë, pas dhënies së këtij miratimi nga Banka e Shqipërisë. Kur Banka e Shqipërisë konstaton moszbatimin e këtij kushti, ajo ka të drejtë të vendosë një ose disa nga masat ndëshkimore të parashikuara në nenin 89 të këtij ligji.

Neni 25

Ndryshimi i pjesëmarrjes influencuese

Nëse një person kërkon të ndryshojë nëpërmjet blerjes, shitjes ose transferimit pjesëmarrjen influencuese të aksioneve në një bankë, kjo kërkesë miratohet paraprakisht nga Banka e Shqipërisë.

Personi, i cili kërkon të zotërojë pjesëmarrje influencuese të aksioneve të bankës, pas miratimit të kësaj kërkese nga asambleja e aksionerëve, i drejtohet Bankës së Shqipërisë për të marrë miratimin paraprak.

Banka e Shqipërisë jep miratimin, sipas pikës 1 të këtij neni, për ndryshimet e pjesëmarrjes influencuese kur plotësohen kushtet e përcaktuara në kreun II të këtij ligji.

Në miratimin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni, Banka e Shqipërisë mund të përcaktojë kushte dhe të vendosë kufizime kohore, të cilat duhet të përmbushen nga një aksioner me pjesëmarrje influencuese, në mënyrë që miratimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni të jetë i vlefshëm.

Banka e Shqipërisë refuzon miratimin e transferimit të pjesëmarrjes influencuese, në qoftë se nga informacioni që ajo ka marrë rezulton se:

nuk plotësohen kushtet e përcaktuara për aksionerët e bankës në kreun II të këtij ligji;

kualifikimet, përvoja e reputacioni i aksionerëve të rinj të propozuar të bankës nuk janë të përshtatshëm për planin e veprimtarisë bankare dhe financiare dhe mund të kenë ndikime negative në mënyrën e administrimit të rrezikut në bankë;

veprimtaritë dhe operacionet që kryhen nga aksionerët e rinj të propozuar të bankës vështirësojnë procesin e mbikëqyrjes;

ç) miratimi i aksionerëve të rinj me pjesëmarrje influencuese në bankën e propozuar cenon kushtet e konkurrencës së lirë në treg, sipas vlerësimit të organit kompetent të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;

d) miratimi i transferimit të pjesëmarrjes influencuese ndikon negativisht në zbatimin e politikës monetare dhe të këmbimit valutor në Republikën e Shqipërisë.

Në qoftë se një person zotëron pjesëmarrje influencuese në bankë pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë, atëherë veprimi që ka sjellë zotërimin e pjesëmarrjes influencuese është absolutisht i pavlefshëm.

Asnjë person nuk mund të jetë aksioner i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në një bankë në qoftë se nuk ka reputacionin e duhur moral, sipas kritereve të këtij ligji ose kërkesave të përcaktuara me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë, ose nuk gëzon pastërtinë penale në kohën e licencimit të bankës ose degës së bankës së huaj.

Nëse pas licencimit ose miratimit të Bankës së Shqipërisë si aksioner, personi nuk plotëson më kërkesat e parashikuara në ligj ose në akte nënligjore mbi reputacionin moral, apo dënohet me një vendim penal të formës së prerë, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të urdhërojë tjetërsimin e të drejtave të tij të pronësisë mbi aksionet tek të tretët që i plotësojnë këto kushte.

Neni 26

Detyrimi për njoftim

1. Banka ose dega e bankës së huaj njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë në rastet kur:

likuiditeti ose aftësia paguese e bankës ose e degës së bankës së huaj është e kërcenuar, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë;

pozicionet e rrezikut arrijnë kufijtë maksimalë të lejuar të ekspozimit, sipas akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë;

vlerësohet se ka shkaqe të justifikuara për ndërprerjen ose pezullimin e ndonjë veprimtarie financiare të lejuar;

ç) pozicioni financiar i bankës ndryshon në atë masë sa banka nuk zotëron më kapitalin rregullator ose nuk arrin më minimumin e raportit të mjaftueshmërisë të kapitalit të përcaktuar në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë;

kapitali rregullator i bankës bie nën nivelin e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për fillimin e veprimtarisë bankare, ose kur nga dega e bankës së huaj nuk janë respektuar kriteret e investimit, sipas pikave 7 dhe 8 të nenit 59 të këtij ligji;

dh) banka e huaj, e cila ka degë në Republikën e Shqipërisë, është subjekt i veprimeve mbikëqyrëse të autoritetit përgjegjës të vendit të origjinës, për shkelje me pasoja të rënda, sipas përcaktimeve të nenit 80 të këtij ligji;

vlerësohet se ka shkaqe për revokimin e licencës.

2. Banka ose dega e bankës së huaj njofton Bankën e Shqipërisë brenda 30 ditëve për:

a) zmadhimin e kapitalit të bankës ose bankës së huaj, në rastin e degës së bankës së huaj;

b) ndryshimet në strukturën e kapitalit të bankës ose bankës së huaj, në rastin e degës së bankës së huaj;

c) investimet me rrezik të madh, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë;

ç) ndryshime në strukturën organizative;

d) ndryshim të selisë dhe adresës së saj;

dh) investimet e bankës në kapitalin e një personi tjetër juridik;

e) largimin e administratorëve.

Neni 27

Komisionet për licencë

1. Banka e Shqipërisë përcakton me akte nënligjore komision për:

a) përpunimin e kërkesës për licencë;

b) dhënien e licencës;

c) vlefshmërinë e licencës.

2. Komisioni i përcaktuar në shkronjën “a” paguhet me paraqitjen e kërkesës për licencë, sipas nenit 19 të këtij ligji, ndërsa komisioni i përcaktuar në shkronjën “b” paguhet me paraqitjen e dokumentacionit për marrjen e licencës, sipas nenit 20 të këtij ligji. Këto komisione paguhen vetëm një herë. Komisioni i përcaktuar në shkronjën “c” paguhet çdo vit, brenda 30 ditëve nga fillimi i vitit kalendarik.

3. Këto komisione nuk rimbursohen.

Neni 28

Revokimi i licencës

1. Licenca e bankës dhe e degës së bankës huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë revokohet me vendim të Bankës së Shqipërisë kur:

kërkohet nga vetë banka ose banka e huaj për degën e bankës së huaj të licencuar;

ka shkelje të këtij ligji apo të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë, të cilat mund të çojnë ose të shkaktojnë ndodhjen e një prej situatave të parashikuara në nenet 22, 78 dhe 80 të këtij ligji;

banka ose dega e bankës së huaj nuk zotëron dhe nuk është në gjendje të sigurojë fonde të mjaftueshme

dhe, si pasojë, nuk ka mundësi të përmbushë detyrimet e saj ndaj kreditorëve dhe veçanërisht nuk jep më siguri për mjetet që i janë besuar asaj;

ç) banka ose dega e bankës së huaj i ka humbur kushtet, mbi bazën e të cilave ajo është licencuar;

d) licenca është siguruar në bazë të informacionit jo të vërtetë, pavarësisht se është dhënë nga kërkuesi apo ka të bëjë me kërkuesin, duke përfshirë të dhënat për kualifikimet, përvojën ose reputacionin e administratorëve dhe aksionerëve me pjesëmarrje influencuese të propozuar ose parregullsi të tjera materiale të shkaktuara në lidhje me kërkesën për licencë;

dh) banka ose dega e bankës së huaj nuk ka filluar veprimtarinë brenda 6 muajve nga marrja e licencës për të filluar veprimtarinë, ose ka ndërprerë për më shumë se 6 muaj pranimin dhe grumbullimin e depozitave bankare, përveç rasteve kur një ndërprerje e tillë është vendosur nga Banka e Shqipërisë;

e) banka ka kryer operacionet e parashikuara në nenin 24 pika 1 shkronja "f" të këtij ligji pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë;

ë) kontrolli i bankës është transferuar pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë;

f) banka ose dega e bankës së huaj pengon, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve të saj, ushtrimin e veprimtarisë mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë;

g) banka ose dega e bankës së huaj nuk ekzekuton urdhrat për ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje, si dhe ndreqjen e shkeljeve të dispozitave ligjore dhe nënligjore;

gj) banka ka pushuar së ekzistuari si person juridik;

h) Banka e Shqipërisë vendos për kalimin e bankës ose degës së bankës së huaj në proces likuidimi;

i) konstatohet ose ka prova të besueshme se aksionerët ose administratorët e bankës apo administratorët e degës së bankës së huaj janë përfshirë në veprimtari të jashtëligjshme, kanë kryer mashtrime ose kanë përfituar personalisht në mënyrë të jashtëligjshme dhe i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme bankës.

2. Në rastin e situatës së përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë vendos në lidhje me revokimin e licencës së bankës ose degës së bankës së huaj brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës me shkrim nga banka ose dega e bankës së huaj.

3. Banka e Shqipërisë revokon licencën e dhënë degës së bankës së huaj edhe nëse banka e huaj nuk ka ose ka humbur të drejtën për të kryer veprimtarinë bankare në vendin ku ajo ka selinë.

4. Vendimi i Bankës së Shqipërisë për revokimin e licencës i komunikohet menjëherë me shkrim bankës ose degës së bankës së huaj, duke parashtruar edhe arsyet e revokimit. Ky vendim i njoftohet edhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

5. Me hyrjen në fuqi të vendimit të revokimit të licencës, banka ose dega e bankës së huaj ndalohet të kryejë veprimtari bankare e financiare dhe detyrohet të likuidojë, sa më parë që të jetë e mundur, aktivet e saj; të zgjidhë marrëdhëniet kontraktore në lidhje me depozitat monetare pa afat dhe të shlyejë detyrimet e saj. Gjatë kësaj kohe banka ose dega e bankës së huaj vazhdon të jetë subjekt i dispozitave të këtij ligji, njësoj sikur të ishte e licencuar.

Neni 29

Publikimi dhe botimi i vendimit për revokimin e licencës

1. Banka e Shqipërisë publikon vendimin për revokimin e licencës.

2. Vendimi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe në një ose më shumë gazeta kombëtare.

KREU III
ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE KONTROLLI I BANKËS DHE I DEGËS SË BANKËS SË HUAJ

Neni 30

Organizimi

Banka, në organizimin e saj si shoqëri anonime, nuk ka këshill mbikëqyrës. Neni 96, fjalia e parë e nenit 97 dhe nënseksioni II i seksionit IV të ligjit "Për shoqëritë tregtare" nuk zbatohen për bankat.

Për qëllime të këtij ligji, në nenin 98 të ligjit "Për shoqëritë tregtare" termi "Këshilli Mbikëqyrës" zëvendësohet me termin "Asamble e Aksionerëve". Në nenin 136, paragrafi i parë i pikës 4 të ligjit "Për shoqëritë tregtare" termi "Këshilli Mbikëqyrës" zëvendësohet me termin "Këshill Drejtues" dhe çdo përgjegjësi tjetër e këtij këshilli, sipas ligjit "Për shoqëritë tregtare", është përgjegjësi e Këshillit Drejtues.

Neni 31

Pavarësia e bankës

Banka dhe dega e bankës së huaj administrohen dhe drejtohen mbështetur në parimet e tregut të lirë dhe konkurrencës së ndershme. Asnjë subjekt apo person publik nuk duhet të ndërhyjë në mënyrë të paautorizuar për të ndikuar në administrimin dhe drejtimin e bankës ose degës së bankës së huaj, përveç rasteve të zbatimit të akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë, ekzekutimit të urdhrave të organeve gjyqësore ose kur një gjë e tillë parashikohet me ligj.

Neni 32
Drejtimi i bankës dhe i degës së bankës së huaj

1. Banka drejtohet nga këshilli drejtues dhe drejtoria.
2. Organet e bankës janë:
asambleja e aksionerëve;
këshilli drejtues;
drejtoria;
ç) komiteti i kontrollit.

Kompetencat e organeve të bankës përcaktohen në këtë ligj dhe në statut.

Dega e bankës së huaj drejtohet nga drejtoria. Organet e tjera drejtuese të saj janë të njëjta me ato të bankës së huaj.

Neni 33
Aktet e brendshme

1. Veprimtaria e bankës drejtohet dhe rregullohet nga aktet e brendshme të miratuara nga organet drejtuese, të nxjerra në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe statutin e saj dhe që përcaktojnë:
a) strukturën e organizimit, të administrimit dhe të funksionimit të bankës, duke përfshirë njësitë e saj funksionale dhe administrative, funksionet e tyre dhe marrëdhëniet raportuese dhe kontrolluese;
b) detyrat e çdo drejtori dhe të njësive që ai drejton dhe kontrollon;
c) funksionet e njësisë së kontrollit të brendshëm dhe të komiteteve të tjera të brendshme të përhershme;
ç) kufijtë e kompetencave të administratorëve, të punonjësve të tjerë të bankës dhe të çdo personi që kryen veprime në emër dhe për llogari të saj.
2. Aktet e brendshme të degës së bankës së huaj përcaktohen në përputhje me aktet rregullative të bankës së huaj, për sa kohë këto të fundit nuk bien në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 34
Stema dhe vula

Banka ka stemën dhe vulën e saj me shenjat përkatëse.

Neni 35
Përbërja e këshillit drejtues

Këshilli drejtues është organ vendimmarrës dhe mbikëqyrës.

Këshilli drejtues përbëhet nga një numër tek individësh, jo më pak se pesë dhe jo më shumë se nëntë anëtarë. Këshilli drejtues zgjedh nga gjiri i tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, që ngarkohen me mbledhjen e këshillit dhe drejtimin e debatit gjatë seancave të tij.

Anëtarët e këshillit drejtues emërohen nga asambleja e aksionerëve për një periudhë jo më të gjatë se 4 vjet dhe kanë të drejtë të rizgjidhen për të njëjtin mandat pa kufizim. Anëtarët e parë të këshillit drejtues caktohen në statut.

Të paktën një e treta e anëtarëve të këshillit drejtues duhet të zgjidhet nga individë, të cilët në çastin e zgjedhjes dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së mandatit nuk janë të lidhur me marrëdhënie interesash privatë, sipas pikës 2 të nenit 44 të këtij ligji, me bankën, aksionerët që ushtrojnë kontroll mbi bankën ose me drejtuesit e saj ekzekutivë.

Anëtarët e këshillit drejtues mund të shkarkohen në çdo kohë nga asambleja e zakonshme e aksionerëve.

Në rast bashkimi ose ndarjeje, emërimi i anëtarëve të këshillit drejtues bëhet nga asambleja në një mbledhje të jashtëzakonshme të saj.

Anëtarët e drejtorisë mund të jenë anëtarë të këshillit drejtues, me kusht që numri i përgjithshëm i tyre të mos përbëjë shumicën e të gjithë anëtarëve të këshillit drejtues.

Kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit drejtues nuk mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të

drejtorisë.

Në rastin e vendeve bosh që krijohen nga vdekja ose dorëheqja e një ose disa anëtarëve të këshillit drejtues, këshilli, deri në mbledhjen e asamblesë së aksionerëve, mund të zgjedhë anëtarë të përkohshëm nga administratorët e miratuar nga Banka e Shqipërisë. Mbledhja e këshillit drejtues zhvillohet me praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve të këshillit drejtues të emëruar. Vendimi në këtë rast miratohet me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në këtë mbledhje.

Në rastin e përcaktuar në pikën 9 të këtij neni, këshilli drejtues ose drejtoria thërret menjëherë asamblenë e aksionerëve.

Shpërblimi i anëtarëve të këshillit drejtues përcaktohet me vendim të asamblesë së aksionerëve.

Neni 36

Mbledhjet e këshillit drejtues

1. Vendimet e këshillit drejtues janë të vlefshme kur janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të tij.

2. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rastit kur në statutin e bankës parashikohet një shumicë më e lartë.

3. Vota e kryetarit është përcaktuese në rast rezultati të barabartë votash, nëse në statut nuk përcaktohet ndryshe.

Neni 37

Kompetencat e këshillit drejtues

Anëtarët e këshilli drejtues, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, drejtohen nga standardet më të larta të etikës dhe veprojnë duke u mbështetur në informacion të plotë dhe të mjaftueshëm, në mirëbesim, me kujdesin dhe përgjegjësinë e duhur, me përkushtim të plotë ndaj përgjegjësive të tyre dhe në interesin më të mirë të sigurisë dhe të qëndrueshmërisë së veprimtarisë bankare dhe financiare të klientëve dhe aksionerëve të tyre.

Këshilli drejtues ka përgjegjësitë kryesore, të cilat përfshijnë, midis të tjerave:

miratimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe strategjive të bankës, në lidhje me planin e biznesit, menaxhimin rrezikut, buxhetin vjetor;

përcaktimin e objektivave afatgjatë të bankës dhe monitorimin e realizimit të këtyre objektivave;

monitorimin e efektivitetit të praktikave të drejtimit të bankës dhe kryerjen e ndryshimeve të nevojshme për përmirësimin e këtyre praktikave;

ç) krijimin e komiteteve, në rast se është e nevojshme, për trajtimin e çështjeve që paraqesin interes të veçantë për bankën, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kohëzgjatjen e mandatit, përbërjen dhe procedurat e tyre të punës;

përcaktimin e kushteve dhe standardeve për përzgjedhjen, shpërblimin, vlerësimin dhe largimin e drejtorëve të bankës, si dhe monitorimin e praktikave për zëvendësimin e personelit të bankës;

dh) monitorimin dhe trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit të drejtorëve, të anëtarëve të këshillit drejtues dhe të aksionerëve, përfshirë këtu edhe trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit, që mund të rrjedhin nga keqpërdorimi i mjeteve të bankës dhe veprimet me personat e lidhur;

marrjen e masave të nevojshme dhe të mjaftueshme për të siguruar integritetin e sistemeve financiare dhe të kontabilitetit të bankës, duke përfshirë kontrollin e pavarur të bankës dhe duke siguruar ekzistencën e sistemeve të përshtatshme të kontrollit, veçanërisht në lidhje me administrimin e rrezikut, sistemin operacional dhe financiar të bankës, si dhe duke siguruar zbatimin e ligjit dhe praktikave më të mira në fushën bankare;

ë) monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave ligjore e rregullative dhe të praktikave më të mira në sistemin bankar;

mbikëqyrjen e procesit të dhënies së informacionit dhe komunikimin me publikun.

Me qëllim përmbushjen e përgjegjësive të tyre, anëtarët e këshillit drejtues marrin ose kërkojnë informacion të përshtatshëm, të plotë dhe në kohë.

4. Anëtari i këshillit drejtues të bankës mund të delegojë detyrat e tij te persona të tretë të tjerë, por mban përgjegjësi për vendimet e tij.

Neni 38

Komiteti i kontrollit

Komiteti i kontrollit përbëhet nga tre anëtarë që emërohen nga asambleja e aksionerëve për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Anëtarët e komitetit të kontrollit janë individë, të cilët duhet të kenë eksperiencë jo më pak se 3 vjet në

fushën e kontabilitetit ose audititmit.

Komiteti i kontrollit ka këto detyra:

kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse;

shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte;

propozon ekspertin kontabël të autorizuar dhe realizon komunikimin ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm të bankës;

ç) bën vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;

kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së bankës me aktet ligjore dhe nënligjore dhe njofton për përfundimet këshillin drejtues të bankës;

dh) i jep mendim këshillit drejtues të bankës për të gjitha problemet që i kërkohen prej këtij të fundit;

miraton raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka, me qëllim publikimin e tyre.

Komiteti i kontrollit mblidhet jo më pak se tre herë në vit në mbledhje të zakonshme, si dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga këshilli drejtues i bankës. Vendimet merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve. Abstenimet nuk lejohen.

Anëtarë të komitetit të kontrollit nuk mund të jenë punonjës ose drejtues ekzekutivë të bankës. Anëtarët e komitetit të kontrollit mund të jenë anëtarë të këshillit drejtues.

Komiteti i kontrollit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, mund të ndihmohet nga ekspertë të jashtëm të zgjedhur prej tij.

Asambleja e aksionerëve të bankës vendos për shpërblimin e anëtarëve të komitetit të kontrollit.

Komiteti i kontrollit raporton përpara këshillit drejtues dhe e ndihmon këtë të fundit në vendimmarrjen dhe mbikëqyrjen e bankës.

Neni 39

Drejtoria dhe drejtuesit ekzekutivë

Ushtrimi i veprimtarisë së bankës dhe i degës së bankës së huaj drejtohet dhe organizohet në mënyrë të vazhdueshme nga drejtoria e saj.

Drejtoria përbëhet nga një ose më shumë drejtues ekzekutivë.

Neni 40

Kushtet kualifikuese për administratorët

Për të ushtruar funksionin e administratorit të bankës ose të degës së bankës së huaj, individi duhet:

të ketë diplomë universitare, si rregull, në ekonomi ose jurisprudencë;

të ketë reputacion të mirë;

të përmbushë kritere të tjera të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë me aktet nënligjore, lidhur me kualifikimet, përvojën në fushën bankare e financiare, si dhe përvojën në drejtim.

Neni 41

Kushtet skualifikuese për administratorët

Një individ nuk është i përshtatshëm për të ushtruar funksionin e administratorit ose lirohet nga ky funksion me vendim të mbledhjes së asamblesë së aksionerëve të bankës dhe të bankës së huaj, në rastin e degës së bankës së huaj ose të këshillit drejtues, sipas rastit, kur:

është administator i një shoqërie tjetër në Republikën e Shqipërisë, përveç rasteve kur kjo shoqëri është person i lidhur me të;

është aksioner i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i më shumë se 5 për qind të aksioneve me të drejtë vote ose i aksioneve të një banke tjetër ose personi të lidhur me të;

shërben ose ka shërbyer në çdo kohë gjatë periudhës 5-vjeçare paraardhëse si administrator i një banke, e cila ka qenë subjekt i procedurave të likuidimit të detyruar, sipas dispozitave të këtij ligji;

ç) shërben ose ka shërbyer në çdo kohë gjatë periudhës 12-mujore paraardhëse në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;

d) është punonjës i Bankës së Shqipërisë;

dh) është në ndjekje penale ose është shpallur fajtor nga gjykata për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënimin me burgim;

e) ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese të detyrimeve dhe nuk është çliruar ende nga pagesa e detyrimeve të shkuara;

ë) është ndëshkuar nga Banka e Shqipërisë gjatë 5 vjetëve të fundit për shkelje të rëndë të këtij ligji ose për zhvillim të veprimtarisë pa licencën përkatëse të lëshuar nga Banka e Shqipërisë;

f) është punonjës ose ortak i një shoqërie që është ekspert kontabël ose konsulent financiar i një banke ose i një dege të bankës së huaj që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë;

g) detyrimet e tij tejkalojnë pretendimet dhe investimet e tij në bankë, ose kur është i lidhur me persona juridikë, detyrimet e të cilëve ndaj bankës tejkalojnë pretendimet dhe investimet e tyre në bankë;

gj) është kreditor i bankës dhe njëkohësisht vlera e përgjithshme e kredive të tij ndaj bankës tejkalon një të katërtën e aktiveve të saj.

Neni 42

Miratimi i administratorëve

Në funksionin e administratorit emërohet individi, i cili ka marrë miratimin paraprak nga Banka e Shqipërisë.

Kërkesa për miratimin e mësipërm shoqërohet me dokumente që vërtetojnë përmbushjen e kritereve të parashikuara në nenin 40 të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

Neni 43

Shkarkimi i administratorëve

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të urdhërojë bankën ose degën e bankës së huaj për shkarkimin e një administratori kur:

konstaton se administratori nuk ka integritet profesional ose moral të nevojshëm për të shërbyer si administrator;

miratimi i tij është bërë mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara;

administratori ka shkelur dispozitat e këtij ligji ose të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

Neni 44

Parandalimi dhe zgjidhja e konfliktit të interesave

Çdo administrator, me zgjedhjen dhe emërimin e tij, pavarësisht nëse ai merr pjesë ose jo në vendimmarrje, deklaron paraprakisht me shkrim pranë këshillit drejtues interesat e tij privatë, sipas pikës 2 të këtij neni.

Interesa privatë të administratorit janë ata interesa që bazohen ose burojnë nga:

a) marrëdhënie pasurore ose tregtare të drejtpërdrejta ose të tërthorta të çdo lloj natyre;

b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;

c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;

ç) negocime të mundshme për punësim apo për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për administratorin në të ardhmen, pas lënies së detyrës si administrator, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës si administrator në bankë;

d) angazhime në veprimtari të tjera private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura;

dh) marrëdhënie familjare ose të bashkëjetesës.

3. Deklarimi nga administratori i interesave privatë i njoftohet me shkrim këshillit drejtues të bankës herë pas here, por jo më rrallë se një herë në vit.

4. Kurdoherë që shtrohen për diskutim dhe për miratim kontrata ose veprime juridike që kanë lidhje me çështje, në të cilat administratori ka interesa privatë, ai nuk mund të marrë pjesë në diskutim dhe të votojë në marrjen e vendimit për këtë çështje. Prania e administratorit që ka interesa privatë në mbledhjet e organit përkatës të bankës që ka për objekt vendimi çështjen e lidhur me këta interesa, nuk llogaritet për efekt të kuorumit të nevojshëm për marrjen e vendimit për çështjen e mësipërme.

5. Këshilli drejtues është përgjegjës për miratimin e akteve të brendshme që përcaktojnë mënyrat bazë të parandalimit dhe zgjidhjes efikase të konfliktit të interesave. Këshilli drejtues mund të ngrejë dhe të autorizojë komitete ad hoc, të përbëra nga anëtarët joekzekutivë të këtij këshilli, të cilët ngarkohen me përgjegjësinë për trajtimin e përshtatshëm rast pas rasti të konfliktit të interesave në bankë.

6. Kur një administrator nuk deklaron konfliktin e interesave, sipas këtij neni, ose kur kontrata apo veprimi juridik është lidhur në kushtet e ekzistencës së konfliktit të interesave, merren masat e mëposhtme:

organet drejtuese dhe çdo aksioner i bankës i kërkojnë gjykatës deklarimin e pavlefshmërisë së

kontratës ose të veprimit tjetër juridik;

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të pezullojë administratorin për një periudhë deri në një vit;

Banka e Shqipërisë i kërkon bankës shkarkimin e administratorit.

Neni 45

Sistemi i kontrollit të brendshëm

Banka ose dega e bankës së huaj organizon sistemin e kontrollit të brendshëm, me qëllim monitorimin e zbatimit të politikave dhe procedurave të brendshme, vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë bankare dhe monitorimin e përputhshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore.

Qëllimi i kontrollit të brendshëm është të identifikojë ekspozimin e bankës ose degës së bankës së huaj ndaj llojeve të rreziqeve, matjen, administrimin dhe monitorimin e nivelit të tyre.

Sistemi i kontrollit të brendshëm të bankës ose degës së bankës së huaj përbëhet nga një tërësi procedurash, rregullash dhe strukturash, të cilat ekzistojnë brenda saj.

Veprimtaria e kontrollit të brendshëm është pjesë përbërëse e veprimtarisë së përditshme të bankës ose degës së bankës së huaj dhe përfshin kontrollin brenda çdo njësie organizative të saj, kontrolle fizike mbi aktivet dhe mbi informacionin, vlerësimet e përputhshmërisë, kontrollin e sistemit të verifikimit dhe rakordimit të informacionit financiar, si dhe rishikimin periodik të efektivitetit të kontrolleve të mëparshme.

Neni 46

Njësia e kontrollit të brendshëm

Banka ose dega e bankës së huaj krijon njësinë e kontrollit të brendshëm, si pjesë e sistemit të kontrollit të brendshëm. Kjo njësi ka për qëllim të sigurojë një kontroll efektiv të zbatimit të politikave, të rregulloreve dhe procedurave të miratuara nga këshilli drejtues ose drejtoria për degën e bankës së huaj dhe të sigurojë saktësinë e informacionit dhe efektivitetin e masave parandaluese ndaj rreziqeve, me të cilat përballet banka ose dega e bankës së huaj.

Këshilli drejtues përcakton rregullat e funksionimit dhe ushtrimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Punonjësit e njësisë së kontrollit të brendshëm emërohen nga këshilli drejtues i bankës dhe raportojnë në organet përkatëse të bankës, sipas mënyrës së përcaktuar nga këshilli drejtues.

Anëtarët e njësisë së kontrollit të brendshëm të degës së bankës së huaj emërohen nga organet vendimmarrëse të bankës së huaj.

Punonjësit e njësisë së kontrollit të brendshëm nuk mund të kenë asnjë funksion tjetër në bankë ose në degën e bankës së huaj.

Neni 47

Raportet financiare

Banka ose dega e bankës së huaj mban llogaritë kontabël dhe përgatit raportet financiare për pasqyrimin e saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat kontabël të gjendjes së saj financiare, mbi baza individuale ose të konsoliduara.

Llogaritë kontabël dhe raportet financiare përgatiten në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar në ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Banka e Shqipërisë kërkon që çdo bankë dhe degë e bankës të huaj të kenë procedura drejtimi, kontabiliteti dhe mekanizma të mjaftueshëm të kontrollit të brendshëm, mbi baza individuale ose të konsoliduara, në përputhje me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë përcakton formën, tipin, metodologjinë, përmbajtjen e raporteve dhe kohën e raportimit të bankave ose degëve të bankave të huaja në Bankën e Shqipërisë.

Neni 48

Eksperti kontabël i autorizuar

Asambleja e aksionerëve të bankës emëron dhe shkarkon si ekspert kontabël të autorizuar vetëm personin juridik të licencuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuar nga Banka e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kriteret e përzgjedhjes së ekspertëve kontabël të autorizuar, duke përcaktuar kritere si për personin juridik, ashtu edhe për ekspertët individualë të personit juridik.

Banka, për çdo ndryshim të ekspertit kontabël të autorizuar, merr miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

Dega e bankës së huaj i nënshtrohet kontrollit të ekspertit kontabël të autorizuar, i cili kontrollon bankën e huaj, ose ekspertit kontabël të autorizuar të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

Banka ose dega e bankës së huaj njofton zyrtarisht Bankën e Shqipërisë kur kërkon të zëvendësojë ekspertin kontabël të autorizuar dhe ky i fundit njofton zyrtarisht Bankën e Shqipërisë kur jep dorëheqjen.

Eksperti kontabël i autorizuar ose ortaku kryesor në një shoqëri auditimi, që është ekspert kontabël i autorizuar, i cili është përgjegjës për kryerjen e auditimit në emër të shoqërisë së auditimit, duhet të zëvendësohet nga kryerja e auditimit brenda një periudhe maksimale prej 7 vjetësh nga data e caktimit si ekspert kontabël i autorizuar dhe mund të rimarrë pjesë në auditimin e bankës apo degës së bankës së huaj pas mbarimit të një afati kohor prej të paktën 2 vjetësh.

Ortaku kryesor në një shoqëri auditimi, që është ekspert kontabël i autorizuar, i cili është përgjegjës për kryerjen e auditimit në emër të shoqërisë së auditimit, nuk mund të marrë pozita drejtimi apo administrimi në bankën ose degën e bankës së huaj të audituar para mbarimit të një afati kohor prej 2 vjetësh, që nga data e dorëheqjes si ortak kryesor në kryerjen e auditimit në një shoqëri auditimi që është ekspert kontabël i autorizuar.

Një shoqëri auditimi e përzgjedhur si ekspert kontabël i autorizuar nuk mund të realizojë auditimin e më shumë se pesë bankave në të njëjtin vit financiar.

Neni 49

Auditimi i ekspertit kontabël të autorizuar

Eksperti kontabël i autorizuar, i miratuar nga Banka e Shqipërisë, kontrollon dhe vlerëson përputhshmërinë e raporteve financiare të bankës ose degës së bankës së huaj me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Eksperti kontabël i autorizuar kontrollon dhe vlerëson:

llogarinë e humbje-fitimit (pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve);

bilancin kontabël;

raportin për ndryshimet në kapital;

ç) pasqyrën e cash – flow;

zbatimin e politikave të fshirjes së zërave të bilancit;

dh) raportet e konsoliduara;

funksionin e kontrollit të brendshëm;

ë) regjistrimet kontabël;

sistemet e informacionit;

saktësinë dhe plotësimin e raporteve të paraqitura në Bankën e Shqipërisë;

gj) mjaftueshmërinë e procedurave kontabël dhe zbatimin e rregulloreve;

shënimet që shoqërojnë raportet financiare.

3. Eksperti kontabël i autorizuar:

verifikon mbajtjen ose jo në mënyrën e duhur të llogarive kontabël dhe të regjistrimeve financiare, përfshirë metodat e parashikuara nga Banka e Shqipërisë;

përgatit raport vjetor së bashku me opinionet e kontrollit të brendshëm, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjendjes financiare të bankës ose degës së bankës së huaj, duke u bazuar në raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka ose dega e bankës së huaj, në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit;

shqyrton mjaftueshmërinë e kontrollit të brendshëm dhe të praktikave e procedurave kontrolluese, si dhe bën rekomandimet përkatëse.

Neni 50

Raportimi i ekspertit kontabël të autorizuar

Eksperti kontabël i autorizuar u paraqet kopje të raportit të auditimit asamblesë së aksionerëve dhe komitetit të kontrollit të bankës ose autoriteteve përkatëse të bankës së huaj në rastin e degës së bankës së huaj.

Eksperti kontabël i autorizuar i bankës ose i degës së bankës së huaj njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë për fakte apo vendime të bankës ose degës së bankës së huaj, të cilat ai i konstaton gjatë kryerjes së detyrës së tij në bankë dhe që përbëjnë:

shkelje të ligjit, rregulloreve apo kushteve, mbi bazën e të cilave bankës ose degës së bankës së huaj i është dhënë licenca ose të rregullave të brendshme që rregullojnë në mënyrë specifike ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare;

raste mashtrimesh, vjedhje, raste pastrimi parash apo të financimit të terrorizmit;

ndryshime të ndjeshme në rezultatin financiar;

ç) shkelje të statutit dhe rregulloreve të brendshme të bankës ose degës së bankës së huaj;

shkak për refuzimin e certifikimit të llogarive ose të paraqitjes së vërejtjeve prej tij; si dhe

dh) fakte të tjera që mund të rrezikojnë vazhdueshmërinë e veprimtarisë së bankës ose degës së bankës së huaj.

Eksperti kontabël i autorizuar informon Bankën e Shqipërisë për çdo veprim mashtrues të kryer nga nëpunësi i bankës ose i degës së bankës së huaj, si dhe për parregullsitë dhe mangësitë në administrim ose në transaksionet që mund të sjellin humbje.

Eksperti kontabël i autorizuar i bankës ose i degës së bankës së huaj njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë edhe për fakte apo vendime të një subjekti, siç përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, të cilat ai i konstaton gjatë kryerjes së detyrës së tij në këtë subjekt, i cili është person i lidhur me bankën, si pasojë e marrëdhënieve të kontrollit midis tij dhe bankës ose degës së bankës së huaj.

5. Njoftimi i Bankës së Shqipërisë nga eksperti kontabël i autorizuar i bankës ose i degës së bankës së huaj për fakte apo vendime, për të cilat bëhet fjalë në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni, nuk përbën shkelje të kufizimeve të konfidencialitetit, të përcaktuara me dispozita kontraktore, ligjore apo nënligjore, si dhe nuk ngarkon me asnjë lloj përgjegjësie ekspertin e autorizuar kontabël.

Neni 51

Ribërja e auditimit

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë ribërjen e auditimit nga një ekspert tjetër kontabël, në rastet kur eksperti kontabël i autorizuar i bankës ose i degës së bankës së huaj ka kryer një auditim dhe ka paraqitur një raport, i cili nuk është në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit dhe nuk shpreh gjendjen reale të bankës.

Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të përjashtojë ekspertin kontabël për një periudhë 5-vjeçare nga kryerja e auditimit të bankave ose degëve të bankave të huaja.

Neni 52

Afati i raportimit të gjendjes financiare

1. Banka i dërgon Bankës së Shqipërisë, brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, një kopje të raportit vjetor dhe të opinionit të ekspertit kontabël të autorizuar, ku pasqyrohet gjendja financiare dhe kontabël mbi baza individuale dhe të konsoliduara.

2. Dega e bankës të huaj është e detyruar të paraqesë në Bankën e Shqipërisë gjendjen financiare dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar të bankës së huaj, të grupit bankar dhe shoqërisë financiare zotëruese, brenda 4 javëve nga sigurimi i tij.

Neni 53

Transparenca

Banka ose dega e bankës së huaj publikon raporte periodike për gjendjen e saj financiare dhe pozicionin ndaj rreziqeve, të paktën një herë në 3 muaj. Banka e Shqipërisë përcakton me akte nënligjore kërkesat minimale të nevojshme në lidhje me publikimet e mësipërme.

Banka përgatit dhe publikon raportin e saj vjetor, i cili përmban minimalisht:

bilancin kontabël dhe zërat jashtë bilancit;

llogarinë e humbje-fitimit (pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve);

pasqyrën cash – flow;

ç) ndryshimet në kapitalin aksioner;

raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;

dh) pjesëmarrjet e bankës në kapitalin e shoqërive të tjera;

një listë të aksionerëve të bankës me pjesëmarrje mbi 5 për qind të kapitalit dhe të dhëna për pjesëmarrjen e tyre;

ë) një listë të administratorëve të bankës, që kanë pjesëmarrje në kapitalin e bankës dhe të dhëna mbi pjesëmarrjet e tyre;

një përshkrim të shkurtër të parimeve të monitorimit, admninistrimit dhe kontrollit të rrezikut që ndërmerr banka, si dhe instrumentet e përdorura për kufizimin e tij.

Dega e bankës së huaj publikon raportin vjetor, si pjesë përbërëse të raportit vjetor të bankës së huaj ose si raport të veçantë, sipas kërkesave të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “f” të pikës 2 të këtij neni.

Banka dhe dega e bankës së huaj publikojnë interesat për depozitat monetare, për kreditë dhe komisionet për shërbimet e kryera, si dhe metodologjinë e llogaritjes së interesave për depozitat monetare dhe të

shlyerjes së kredive.

Në rastet kur Banka e Shqipërisë konstaton se publikimet e përmendura në pikat 1 deri 4 të këtij neni janë të pasakta ose të paplota, urdhëron korrigjimin dhe ripublikimin e tyre, si dhe mund të marrë masa ndëshkimore të parashikuara në nenin 89 të këtij ligji.

KREU IV
VEPRIMTARITË E LEJUESHME PËR BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA

Neni 54
Veprimtaritë bankare dhe financiare

1. Banka ose dega e bankës së huaj licencohet të kryejë veprimtaritë bankare, sipas përcaktimit të nenit 4 të këtij ligji dhe veprimtaritë financiare të përshkruara në pikën 2 të këtij neni.

2. Veprimtari financiare konsiderohen:

a) të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore e kredinë hipotekore;

b) faktoringun dhe financimin e transaksioneve tregtare;

c) qiranë financiare;

ç) të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, duke përfshirë kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit, çeqet bankare dhe kartat e pagesës;

d) ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve;

dh) tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:

i) instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, certifikata të depozitave etj.);

ii) këmbim valutor;

iii) produkte derivative (instrumente derivative), duke përfshirë, midis të tjerave, kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me opsione (options);

iv) instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla, si marrëveshje swap dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen;

v) letra me vlerë të transferueshme;

vi) instrumente të tjera të negociueshme dhe aktive financiare, duke përfshirë veprimet me arin;

vii) pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agjent (si publik, ashtu edhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me këto emetime;

e) ndërmjetësimin për transaksionet monetare të mëposhtme:

i) administrimin e aktiveve të tilla, si administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve, marrja në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit;

ii) shërbimin për kompensimin dhe shlyerjen e pagesave të aktiveve financiare, duke përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumente të tjera të negociueshme;

iii) sigurimin dhe transferimin e informacionit financiar, si dhe përpunimin e të dhënave financiare e të programeve që kanë lidhje me të, nga furnizuesit e shërbimeve të tjera financiare;

ë) shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara në shkronjat “a” deri “ë” të këtij neni, duke përfshirë referencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive.

Banka ose dega e bankës së huaj nuk ka të drejtë të marrë pjesë drejtpërdrejt në veprimtari industriale, tregtare ose të kryejë shërbime jobankare, veç atyre bankare dhe financiare të parashikuara në këtë ligj.

4. Banka ose dega e bankës së huaj ushtron veprimtaritë e përshkruara në pikën 2 të këtij neni pas licencimit nga autoritetet rregullatore përkatëse, nëse licencimi kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Neni 55
Dokumentacioni i bankës ose i degës së bankës së huaj

1. Banka përgatit dhe mban në drejtorinë qendrore të saj dokumentacionin e mëposhtëm:

statutin dhe rregulloret e brendshme me të gjitha amendamentet e tyre;

b) regjistrin e aksionerëve të saj, duke përfshirë edhe numrin e aksioneve të regjistruara në emër të çdo aksioneri;

c) protokollin e mbledhjeve dhe vendimet e këshillit drejtues;

ç) protokollin e mbledhjeve dhe vendimet e asamblesë së aksionerëve;

d) politikat dhe procedurat për njohjen, mbikëqyrjen dhe administrimin e të gjitha llojeve të rreziqeve

për veprimtarinë së bankës, si dhe politikat përkatëse për rezervat, në zbatim të akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë;

dh) dokumentacionin kontabël, që pasqyron qartë e në mënyrë korrekte gjendjen e veprimtarisë së saj tregtare, duke shpjeguar transaksionet dhe pozicionin financiar, në mënyrë që t'i krijojë Bankës së Shqipërisë mundësitë për të përcaktuar nëse subjekti vepron në përputhje me të gjitha dispozitat e këtij ligji;

e) çdo dokument tjetër që parashikohet si i domosdoshëm nga ky ligj ose nga aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë dhe nga legjislacioni në fuqi.

2. Dega e bankës së huaj përgatit dhe mban në selinë e saj dokumentacionin e mëposhtëm:

statutin e bankës së huaj dhe rregulloret e brendshme të saj me të gjitha amendamentet e tyre;

protokollin e mbledhjeve të drejtorisë së saj;

politikat dhe procedurat për njohjen, mbikëqyrjen dhe administrimin e të gjitha llojeve të rreziqeve për veprimtarinë e degës së bankës së huaj, si dhe politikat përkatëse për rezervat, në zbatim të akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë;

ç) dokumentacionin kontabël, që pasqyron qartë e në mënyrë korrekte gjendjen e veprimtarisë së saj tregtare, duke shpjeguar transaksionet dhe pozicionin financiar, në mënyrë që t'i krijojë Bankës së Shqipërisë mundësitë për të përcaktuar nëse subjekti vepron në përputhje me të gjitha dispozitat e këtij ligji;

çdo dokument tjetër që parashikohet si i domosdoshëm nga ky ligj ose nga aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë dhe nga legjislacioni në fuqi.

3. Për qëllime të veprimtarisë së mbikëqyrjes, banka ose dega e bankës së huaj përgatit pasqyra financiare në formën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

4. Banka ose dega e bankës së huaj publikon rregullisht pasqyrat financiare, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Neni 56

Dokumentacioni për transaksionet e kredisë

Banka ose dega e bankës së huaj, për çdo transaksion kredie, detyrohet të mbajë të paktën dokumentet e mëposhtme:

kërkesën për kredi, dokumentet që tregojnë përdorimin e kredisë dhe statusin ligjor;

përshkrimin e çdo kolaterali, nëse ka, të cilin kredidhënësi e mban si mjet për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit që do të paguhet si pjesë e borxhit dhe një vlerësim të vlerës së tij;

deklaratën e plotë financiare të kredimarrësit dhe të çdo garantuesi të borxhit të kredimarrësit;

ç) marrëveshjen e kredisë, përfshirë shumën monetare kryesore (kryegjënë), përqindjen e interesit, planin e shlyerjes dhe objektin e kredisë ose të qëllimit të marrjes së kredisë;

vendimin që miraton transaksionin e kredisë, të nënshkruar nga personat përgjegjës, ose një kopje e protokollit të mbledhjes, kur vendimi merret nga këshilli drejtues i bankës;

dh) nënshkrimin e çdo personi që është i autorizuar për dhënien e kredisë në emër të kredidhënësit.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë dokumente e procedura plotësuese tej kushteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

KREU V

ADMINISTRIMI I RREZIKUT

Neni 57

Dispozita të përgjithshme

Banka siguron një nivel të mjaftueshëm kapitali në raport me veprimtaritë e lejuara që ushtron, shtrirjen e tyre, si dhe tërësinë e rreziqeve, ndaj të cilave banka ekspozohet.

Banka ose dega e bankës së huaj ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë që rreziku, ndaj të cilit ajo ekspozohet për veprimtari të veçanta apo për të gjithë veprimtarinë, të jetë brenda kufizimeve të vendosura në mënyrë individuale ose të konsoliduar, të përcaktuara në këtë ligj ose në akte nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

Banka ose dega e bankës së huaj, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, përmbush detyrimet e saj në kohën e duhur dhe në mënyrë të vazhdueshme.

Banka ose dega e bankës së huaj, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, përcakton kriteret dhe harton metodat e procedurat për identifikimin dhe monitorimin e të gjitha rreziqeve, në përputhje me aktet e brendshme rregullative të bankës ose degës së bankës së huaj, të miratuara nga këshilli drejtues i saj.

Banka ose dega e bankës së huaj vlerëson në mënyrë të vazhdueshme rreziqet dhe krijon fonde rezervë për mbulimin e tyre.

Neni 58
Rregullat për administrimin e rrezikut

Banka e Shqipërisë, me akte nënligjore, përcakton rregulla për:
llogaritjen e aktiveve të ponderuara me rrezikun;
llogaritjen e ekspozimeve ndaj rrezikut ose rreziqeve;
parimet e vlerësimit të tipologjisë së rreziqeve;
ç) klasifikimin dhe matjen e rrezikut të humbjes nga falimentimi i kundërpartisë;
llogaritjen dhe përcaktimin e pozicionit të hapur valutor.

Neni 59
Kapitali rregullator, mjaftueshmëria e kapitalit dhe garancia

Banka, për ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të saj ndaj kreditorëve, mban kapitalin rregullator në një nivel të mjaftueshëm.

2. Struktura, elementet përbërëse dhe metoda e llogaritjes së kapitalit rregullator të bankës përcaktohen me akte nënligjore të miratuara nga Banka e Shqipërisë.

3. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit rregullator përcaktohet në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, por ai është jo më pak se 8 për qind.

4. Në raste të veçanta, Banka e Shqipërisë, me akte nënligjore, ka të drejtë të përcaktojë për një bankë një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit rregullator më të lartë sesa raporti i përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, nëse ajo konstaton se banka ushtron ose përfshihet në veprimtari me rrezik të lartë.

5. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë bankare, kapitali rregullator i bankës ose pjesë të tij nuk duhet të bien nën nivelin e kapitalit fillestar minimal të kërkuar në çastin e licencimit të saj.

6. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit rregullator llogaritet mbi baza individuale ose të konsoliduara.

Dega e bankës së huaj, për ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të saj ndaj kreditorëve, duhet të investojë një pjesë të kapitalit të saj fillestar minimal të dhuruar në të paktën një prej aktiveve të mëposhtme:

depozitë në Bankën e Shqipërisë me normë interesi të përcaktuar me marrëveshje midis tyre;

letra me vlerë të emetuara nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë;

aktive me rrezik të vogël, në përputhje me aktet rregullative përkatëse të Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë përcakton me akte nënligjore kriteret e investimit, sipas pikës 7 të këtij neni, në raport me kapitalin fillestar minimal të dhuruar dhe të paguar në para nga banka e huaj për hapjen e degës.

Aktivet, sipas pikës 7 të këtij neni, shërbejnë si garanci për shlyerjen e detyrimeve të degës së bankës së huaj ndaj të tretëve në Republikën e Shqipërisë, në rast se ajo i nënshtrohet procedurave të likuidimit.

Neni 60
Aktivet e ponderuara me rrezikun

1. Aktivet e ponderuara me rrezikun përbëjnë shumën e vlerave kontabël të zërave të aktiveve të bilancit dhe jashtë bilancit, të ponderuara me rrezikun e kredisë, tregut dhe të rreziqeve të tjera.

2. Koeficientët e ponderimit për zërat e aktiveve brenda dhe jashtë bilancit përcaktohen nga Banka e Shqipërisë me akt nënligjor.

3. Përveç rasteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, banka mundet që, me miratimin e Bankës së Shqipërisë, të zbatojë metoda dhe modele të tjera për vlerësimin e rrezikut të kredisë, tregut dhe rreziqeve të tjera.

Neni 61
Rreziku i kredisë

1. Rreziku i kredisë nënkupton rrezikun që rrjedh nga pamundësia e kredimarrësit dhe e garantuesit të kredisë ose të kundërpartisë për aktivet e tjera, për të përmbushur detyrimet ndaj bankës ose degës së bankës së huaj, sipas kushteve të marrëveshjes së lidhur midis tyre.

2. Banka ose dega e bankës së huaj, sipas kërkesave të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë:

klasifikon dhe vlerëson aktivet e saj brenda dhe jashtë bilancit;

krijon fonde rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga zhvlerësimi i aktiveve, mbi bazën e klasifikimeve dhe vlerësimeve të saj;

harton metoda të brendshme vlerësimi për rrezikun e kredisë.

Banka ose dega e bankës së huaj mban një dokumentacion të plotë dhe të qartë lidhur me çdo fazë të

procesit të dhënies së kredisë dhe procesit të investimit, duke realizuar një administrim të saktë të procesit të kredidhënies, masave dhe mënyrës së monitorimit të tij, si dhe kontrollin e duhur mbi rrezikun e kredisë.

Klasifikimi i aktiveve brenda dhe jashtë bilancit të bankës ose të degës së bankës së huaj bëhet duke vlerësuar minimalisht:

aftësinë paguese të debitorit;

mënyrën në të cilën një debitor përmbush detyrimet e tij;

cilësinë e kolateralit, nëse ka;

ç) aftësinë paguese të garantuesit.

Banka ose dega e bankës së huaj monitoron veprimet e kredimarrësit dhe vlerën e kolateralit për pretendimet e saj gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes së kredisë, që përbën ekspozim ndaj rrezikut.

Neni 62

Ekspozimi ndaj rrezikut dhe kufizimet

1. Ekspozimi i bankës ose i degës së bankës së huaj ndaj një personi ose një pale të tretë është shuma e të gjitha marrëdhënieve në aktiv të bilancit dhe angazhimeve jashtë bilancit me këtë person ose kundërparti dhe me personat e lidhur me të.

2. Në ekspozimin e bankës ose të degës së bankës së huaj ndaj një personi nuk përfshihen:

a) pretendimet që rrjedhin nga marrëdhëniet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, të siguruara me barrë me një depozitë monetare, deri në shumën e kësaj barre siguruese;

b) letrat me vlerë të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose të Bankës së Shqipërisë apo një garanci e patjetërsueshme e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ose një kolateral të parashikuar me vendim të Bankës së Shqipërisë.

Neni 63

Ekspozimet e mëdha

1. Ekspozimi i bankës ndaj një klienti ose grupi klientësh të lidhur konsiderohet ekspozim i madh kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 10 për qind e kapitalit rregullator.

2. Banka i raporton Bankës së Shqipërisë në lidhje me çdo ekspozim të madh, sipas kuptimit të pikës 1 të këtij neni, në mënyrën dhe kohën e përcaktuar në aktet ligjore të Bankës së Shqipërisë.

3. Bankat hartojnë procedura administrative dhe kontabël, si dhe mekanizma të kontrollit të brendshëm për të identifikuar, regjistruar dhe monitoruar të gjitha ekspozimet e mëdha dhe ndryshimet e tyre.

Neni 64

Ekspozimi maksimal i lejueshëm

1. Ekspozimi i bankës ndaj një personi ose personave të lidhur me të nuk mund të tejkalojë 20 për qind të kapitalit rregullator.

2. Kur personi ose grupi i personave të lidhur është shoqëria mëmë, filial i bankës, apo një ose më shumë filiale të shoqërisë mëmë, ekspozimi nuk mund të tejkalojë 25 për qind të kapitalit rregullator.

3. Ekspozimi i bankës ndaj personave të lidhur me të nuk mund të tejkalojë 10 për qind të kapitalit të saj rregullator.

4. Banka nuk merr përsipër ekspozime të mëdha, të cilat, të marra së bashku, tejkalojnë 700 për qind të kapitalit rregullator.

5. Banka respekton në çdo kohë kufizimet e përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij neni, në lidhje me ekspozimet e saj. Në rast se ekspozimet tejkalojnë kufizimet e mësipërme, banka raporton menjëherë në Bankën e Shqipërisë, e cila përcakton masat e nevojshme dhe kohën për të rivendosur ekspozimet brenda kufizimeve të mësipërme.

Neni 65

Ekspozimi ndaj personave me një marrëdhënie të veçantë me bankën

Këshilli drejtues miraton paraprakisht me 2/3 e votave të gjitha veprimet e bankës, si rezultat i të cilave lind ose rritet ekspozimi i bankës ndaj personave të parashikuar në shkronjat “a” deri në “dh” të përkufizimit për “personat e lidhur” pika 9. 2 e nenit 4 të këtij ligji.

Neni 66

Rreziku i likuiditetit

1. Bankat ose degët e bankave të huaja mbajnë likuiditetin në një shumë, strukturë dhe raporte që i lejojnë ato të përmbushin detyrimet e tyre dhe angazhimet e marra, sipas afateve kohore në një kosto të arsyeshme dhe me një rrezik minimal.

2. Me qëllim administrimin e rrezikut të likuiditetit, në mënyrë efektive, banka ose dega e bankës së huaj harton dhe zbaton politika lidhur me:

a) planifikimin e lëvizjeve të cash-it, përfshirë edhe ngjarjet e papritura;

b) monitorimin në vazhdimësi të likuiditeteve;

c) marrjen e masave të duhura për parandalimin ose eliminimin e shkaqeve të mungesës së likuiditetit.

Neni 67

Rezerva e detyrueshme

Banka ose dega e bankës së huaj mban depozita pranë Bankës së Shqipërisë, siç parashikohet në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", në nivele minimale të përcaktuara nga kjo e fundit, të quajtura rezerva të detyrueshme, të cilat lidhen me shumën e pasiveve apo ndryshimeve të tyre ose të kategorive specifike të pasiveve.

Neni 68

Rezervat për mbulimin e humbjeve

1. Banka dhe dega e bankës së huaj vlerësojnë vazhdimisht rreziqet e kredisë dhe krijojnë rezervat për mbulimin e humbjeve të shkaktuara nga huatë dhe pretendime të ngjashme, si edhe nga detyrimet e mundshme që ndodhen jashtë bilancit.

2. Rezervat për mbulimin e humbjeve të identifikuara, apo që mund të krijohen bazuar në përvojën e kaluar, që ekzistojnë në portofolin e kredive apo që kanë rezultuar nga detyrimet e mundshme jashtë bilancit, krijohen duke debituar shpenzimet e bankës.

3. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor metodën e llogaritjes së rezervave të parashikuara në këtë nen dhe kriteret e klasifikimit në varësi të rrezikut të kredive, pretendimeve të ngjashme ose të detyrimeve të mundshme jashtë bilancit.

Neni 69

Shpallja e normave të interesit

Banka dhe dega e bankës së huaj shpallin rregullisht afatet dhe kushtet e llogaritjes së normave të interesit, që lidhen me depozitat monetare, kreditë ose huatë dhe ndryshimet e tyre, metodologjinë e llogaritjes së tyre, sipas mënyrës dhe formës së parashikuar në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 70

Investimet në kapital

1. Banka mund të investojë në blerjen e aksioneve të shoqërive tregtare që nuk janë banka apo institucione financiare ose të marrë pjesë si ortak në këto shoqëri tregtare për një shumë jo më të madhe se 10 për qind të kapitalit të asaj shoqërie, por ky investim, në çdo rast, nuk duhet të jetë më i madh se 15 për qind të kapitalit rregullator të bankës.

2. Investimi maksimal i lejuar i një banke në disa shoqëri tregtare, që nuk janë banka apo institucione financiare, ose pjesëmarrja si ortak në këto shoqëri tregtare nuk mund të jetë më i madh se 60 për qind të kapitalit rregullator të bankës.

3. Banka nuk mund të bëjë zvogëlimin e kapitalit nëpërmjet riblerjes së aksioneve ose shpërndarjes së fondeve rezervë pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

4. Banka e Shqipërisë, me akte nënligjore, mund të vendosë rregulla të tjera shtesë që lidhen me kufizimet e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni për dhënien ose jo të miratimit të investimit.

5. Kufizimet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për:

përfitimin e aksioneve ose të të drejtave të tjera të pronësisë kundrejt shlyerjes së kredive të dhëna. Në këtë rast banka përfituese i disponon të gjitha aksionet ose të drejtat e pronësisë të fituara për një vit, me përjashtim të rastit kur Banka e Shqipërisë e ka zgjatur këtë afat;

përfitimin e aksioneve ose të drejtave të tjera të pronësisë si agjent;

blerjen e aksioneve ose të drejtave të pronësisë me qëllim rishitjen e tyre tek të tretët.

KREU VI
PROCESI I MBIKËQYRJES

NËNKREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR MBIKËQYRJEN

Neni 71
Autoriteti mbikëqyrës

Banka e Shqipërisë është autoriteti që mbikëqyr bankat, degët e bankave të huaja në territorin e Republikën e Shqipërisë dhe degët e bankave të licencuara nga Banka e Shqipërisë që veprojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas dispozitave të këtij ligji.

Banka e Shqipërisë mbikëqyr bankat dhe veprimtaritë bankare dhe financiare në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 72
Ushtrimi i mbikëqyrjes

Banka e Shqipërisë realizon procesin e mbikëqyrjes nëpërmjet:

a) licencimit;

b) kuadrit rregullator;

c) analizës financiare dhe parashikuese, verifikimit të të dhënave të raportuara periodikisht nga bankat ose degët e bankave të huaja;

ç) inspektimeve të plota dhe të pjesshme të veprimtarisë bankare;

d) veprimeve korrigjuese në zbatim të kuadrit të plotë mbikëqyrës;

dh) marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet e huaja mbikëqyrëse dhe me bankat e huaja që kanë hapur degën ose filialin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Subjektet e këtij ligji vënë në dispozicion të Bankës së Shqipërisë dokumentacionin e nevojshëm, me qëllim realizimin e procesit të mbikëqyrjes.

Në përmbushjen e funksionit të saj mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë vlerëson ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e ushtrimit të veprimtarisë bankare dhe financiare, aftësinë e një banke ose të degës së bankës së huaj për administrimin e rrezikut, me të cilin ajo përballet dhe urdhëron marrjen e masave për të eliminuar shkeljet dhe parregullsitë e vërejtura, si dhe për përmirësimin e situatës financiare të bankës ose degës së bankës së huaj.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë t'i kërkojë autoritetit mbikëqyrës të bankës së huaj informacionin e nevojshëm lidhur me mbikëqyrjen e personave të lidhur me këtë bankë.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë informacion nga shoqëritë që kanë pjesëmarrje influencuese në banka dhe shoqëritë që janë në zotërim të përbashkët me bankat, për qëllim të mbikëqyrjes së bankave.

Neni 73
Mbikëqyrja e bankës, degës së bankës së huaj dhe degës së bankës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Banka, dega e bankës së huaj, dega e bankës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik, që ka pjesëmarrje influencuese në bankë, janë objekt kontrolli nga inspektorët e Bankës së Shqipërisë dhe nga eksperti kontabël i autorizuar. Banka e Shqipërisë dhe eksperti kontabël i autorizuar kanë të drejtë:

të kontrollojnë dhe të shqyrtojnë llogaritë kontabël, librat e shoqërisë, dokumentet dhe çdo të dhënë tjetër në arkivat e tyre;

të kërkojnë në çdo kohë nga administratorët, nëpunësit dhe agjentët e bankës ose të degës së bankës së huaj të japin informacione për çështje që lidhen me administrimin, drejtimin dhe transaksionet. Informacionet përgatiten në formën e parashikuar nga Banka e Shqipërisë dhe eksperti kontabël i autorizuar, sipas planit kontabël të miratuar.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të lidhë marrëveshje përkatëse, bazuar mbi parimin e reciprocitetit me autoritetin mbikëqyrës të vendit të huaj për inspektimin e degës ose filialit të bankës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim mbikëqyrjen bankare në atë vend.

Bilancet kontabël dhe raportet financiare të degëve të bankës së huaj përgatiten në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Banka përgatit dhe i paraqet Bankës së Shqipërisë një ose disa raporte për vlerësimin e gjendjes financiare të bankës dhe të degës së bankës së huaj, sipas rastit, në mënyrë individuale ose të konsoliduar, në bazë të kërkesave të parashikuara në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Nëpunësit e autorizuar të autoritetit mbikëqyrës të një vendi tjetër, të ngarkuar për mbikëqyrjen bankare në atë vend, në marrëveshje me Bankën e Shqipërisë, mund të lejohen për inspektimin e një banke që:

a) është degë ose filial i bankës së huaj, e cila ka drejtorinë qendrore në atë vend;

b) ka pjesëmarrje influencuese në bankën e huaj, selia e së cilës është në atë vend.

Banka dhe dega e bankës së huaj lejojnë kontrollin dhe bashkëpunojnë me inspektorët e Bankës së Shqipërisë dhe me ekspertët kontabël të autorizuar, të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

Dega e bankës së huaj, të paktën një herë në vit, informon Bankën e Shqipërisë për emrat e aksionerëve dhe pjesëmarrjet e tyre në kapitalin e bankës së huaj.

Neni 74

Masat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në bazë të përfundimeve të procesit të mbikëqyrjes ose të çdo lloj informacioni tjetër të disponueshëm, përcakton nëse një bankë ose degë e bankës së huaj zbaton ose jo kuadrin ligjor dhe rregullativ për një veprimtari të sigurt dhe të qëndrueshme bankare. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë urdhëron masa mbikëqyrëse ndaj subjekteve të këtij ligji.

Banka e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, merr ndaj bankës ose degës së bankës së huaj një ose disa nga masat e mëposhtme:

paralajmëron për mosrespektimin e standardeve për një veprimtari të sigurt dhe të qëndrueshme;

urdhëron ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje, si dhe ndreqjen e shkeljeve të dispozitave ligjore ose nënligjore;

vendos sanksione;

ç) vendos bankën në kujdestari;

revokon licencën;

dh) fillon procedurat e likuidimit të detyrueshëm.

3. Banka e Shqipërisë përcakton kushtet e hollësishme dhe metodat për vendosjen dhe miratimin e masave mbikëqyrëse.

Neni 75

Masa parandaluese

Banka e Shqipërisë paralajmëron bankën ose degën e bankës së huaj për mosrespektimin e standardeve për një veprimtari të sigurt dhe të qëndrueshme dhe për këtë qëllim kërkon prej saj paraqitjen e një plani ose marrëveshjeje për ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje dhe ndreqjen e shkeljeve të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe respektimin e standardeve për një veprimtari të sigurt dhe të qëndrueshme.

Banka ose dega e bankës së huaj paraqet në Bankën e Shqipërisë planin apo marrëveshjen e mësipërme brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, sipas pikës 1 të këtij neni ose sipas afatit të caktuar nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së planit ose marrëveshjes së propozuar nga banka ose dega e bankës së huaj, njofton me shkrim këtë të fundit për miratimin ose jo të tyre, si dhe kërkon informacion shtesë, nëse gjykohet e arsyeshme. Banka e Shqipërisë mund të zgjasë afatin, brenda të cilit jepet njoftimi për miratimin e planit ose marrëveshjes.

Banka e Shqipërisë ndërmerr veprime të mëtejshme në rast të mosrespektimit të detyrimeve që rrjedhin nga pikat 1 deri 3 të këtij neni.

Neni 76

Urdhri për ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje

Banka e Shqipërisë urdhëron ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje, si dhe ndreqjen e shkeljeve të dispozitave ligjore ose nënligjore, në qoftë se gjatë mbikëqyrjes konstaton se:

nuk përmbushen kushtet për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare;

shkelen rregullat e administrimit të rrezikut;

shkelen rregullat e mbajtjes së kontabilitetit;

ç) shkelen rregullat e kontrollit e brendshëm;

shkelet detyrimi në lidhje me raportimet dhe njoftimet;

dh) administratori i bankës ose degës së bankës së huaj nuk ka marrë miratimin paraprak nga Banka e Shqipërisë;

e) nuk zbatohen kriteret e investimit, sipas nenit 59 pika 8, në rastin e degës së bankës së huaj;

ë) shkelen dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe në zbatim të tij.

2. Banka e Shqipërisë përcakton afatet për eliminimin e shkeljeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Në rast të ndryshimit të rrethanave, çdo bankë ose degë e bankës së huaj, ndaj së cilës Banka e Shqipërisë ka nxjerrë urdhër, sipas pikës 1 të këtij neni, mund t'i kërkojë me shkrim Bankës së Shqipërisë rishikimin e kushteve të nxjerrjes së urdhrit për ndryshim ose revokim të tij.

Neni 77

Raportimi mbi zbatimin e urdhrit

Banka ose dega e bankës së huaj, brenda afatit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në urdhrin e nxjerrë prej saj, i paraqet kësaj të fundit një raport të detajuar për masat e marra për eliminimin e shkeljeve.

Banka e Shqipërisë, me marrjen e raportit, sipas pikës 1 të këtij neni, verifikon eliminimin e shkeljeve.

Banka e Shqipërisë merr vendim për të pranuar ose jo raportin mbi eliminimin e shkeljeve brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e tij.

Neni 78

Shkelje të rregullave për administrimin e rrezikut

Janë shkelje të rregullave për administrimin e rrezikut nga ana e bankës dhe degës së bankës së huaj rastet e mëposhtme:

aftësia paguese e bankës ose likuiditeti i degës së bankës së huaj ka rënë nën nivelin e kërkuar;

banka ose dega e bankës së huaj ushtron veprimtari, të cilat nuk janë përfshirë në aneksin e licencës;

dega e bankës së huaj ushtron veprimtari, për të cilat banka e huaj nuk është e licencuar;

ç) banka ose dega e bankës së huaj ushtron veprimtari, të cilat rrezikojnë likuiditetin dhe aftësinë paguese.

Banka e Shqipërisë me akt nënligjor përcakton afatet e ndreqjes së shkeljeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 79

Masat për zbatimin e rregullave të administrimit të rrezikut

Banka e Shqipërisë, nëse gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së veprimtarisë bankare dhe financiare, konstaton shkelje të rregullave të administrimit të rrezikut, përveç urdhrit për eliminimin dhe ndreqjen e veprimeve në kundërvajtje, të parashikuara në nenin 76 pika 1, urdhëron gjithashtu:

bankën ose degën e bankës së huaj të hartojë një plan për të arritur nivelin e kërkuar të aftësisë paguese të shoqërisë;

bankën të thërrasë asamblenë e aksionerëve dhe t'i propozojë asaj rritjen e kapitalit themeltar nëpërmjet investimeve të reja ose me anë të fitimit (duke mos shpërndarë dividentë);

bankën ose degën e bankës së huaj të ndalojë kryerjen e pagesave për persona juridikë të caktuar;

ç) pezullimin e plotë ose të pjesshëm të pagesës së dividendit apo të ndonjë forme tjetër të pagesës së fitimit;

marrjen e masave për uljen e shpenzimeve operative të bankës ose degës së bankës së huaj, duke përfshirë kufizimet mbi pagat dhe të ardhurat e tjera të personave përgjegjës dhe punonjësve të tjerë të bankës apo degës së bankës së huaj, si dhe kufizimet në zgjerimin e rrjetit të bankës ose degës së bankës së huaj;

dh) marrjen e masave për kufizimin e rritjes së mjeteve të bankës ose degës së bankës së huaj, duke përfshirë zërat jashtë bilancit me rrezik;

marrjen e masave për të kërkuar nga banka dhe dega e bankës së huaj ose nga persona të lidhur me to, që të ndryshojnë, zvogëlojnë ose të ndërpresin kryerjen e një veprimtarie, për të cilën Banka e Shqipërisë ka përcaktuar se ka krijuar humbje të konsiderueshme për bankën ose degën e bankës së huaj apo që paraqet një rrezik të madh për të;

ë) ndërprerjen e një ose disa veprimtarive bankare dhe financiare të bankës ose degës së bankës së huaj;

urdhëron përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me sigurimin e depozitave monetare.

2. Banka e Shqipërisë, kur konstaton shkelje të rënda të rregullave të administrimit të rrezikut, ka të drejtë të urdhërojë organet drejtuese të bankës ose degës së bankës së huaj për të shkarkuar një ose disa administratorë ekzekutivë dhe zëvendësimin e tyre brenda një periudhe 1- mujore.

Neni 80
Shkelje me pasoja të rënda

Banka ose dega e bankës së huaj, gjatë ushtrimit të veprimtarisë bankare dhe financiare, konsiderohet se ka kryer shkelje me pasoja të rënda, sipas dispozitave të këtij ligji, në raste kur:

ka shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore, për shkak të të cilave banka ose dega e bankës së huaj ka pësuar një humbje të ndjeshme financiare;

nuk është pranuar ose është refuzuar ndërprerja e veprimeve në kundërvajtje, si dhe ndreqja e shkeljeve të dispozitave ligjore ose nënligjore;

ka shkelje të ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe si rezultat nuk arrihet të përcaktohet gjendja financiare e bankës;

ç) ekziston një mospërputhje me standardet e një veprimtarie të sigurt dhe të qëndrueshme bankare, për një periudhë relativisht të gjatë;

ka probleme serioze në sistemet dhe në programet e kontrollit të brendshëm, në politikat e veprimtarisë, në metodat e operacioneve ose në sistemet e informacionit të administrimit të saj, pavarësisht se këto probleme kanë ndikuar ose jo në gjendjen financiare të bankës apo degës së bankës së huaj;

dh) ka fakte konkrete, lidhur me abuzime të brendshme, pavarësisht faktit se banka ose dega e bankës së huaj aktualisht nuk rezulton e dëmtuar;

ka shkelje të vullnetshme ose flagrante të akteve ligjore dhe nënligjore nga personeli dhe organet drejtuese ose përsëritje të tyre;

ë) ka shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore, të kryera nga punonjës ose nga persona të lidhur të bankës ose degës së bankës së huaj, të cilat kanë sjellë përfitime materiale apo favore nga veprimtaria bankare dhe financiare.

f) ka shkelur detyrimin për sigurimin e depozitave, sipas ligjit "Për sigurimin e depozitave".

Neni 81
Masat për zbatimin e kërkesave për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit

Banka e Shqipërisë, nëse gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së veprimtarisë bankare dhe financiare, konstaton se raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës është më i ulët se raporti minimal i përcaktuar në nenin 59 të këtij ligji, urdhëron:

a) ndalimin e ndarjes së fitimit;

b) uljen e shpenzimeve të bankës;

c) kufizimin e rritjes së mjeteve financiare të bankës, duke përfshirë zërat jashtë bilancit me rrezik;

ç) ndalimin e bankës për të kryer investime në pjesëmarrje në persona të tjerë juridikë;

d) ndalimin e hapjes së degëve të reja, zgjerimin e rrjetit bankar, si dhe fillimin e veprimtarive të reja;

dh) ndalimin e rritjes së ekspozimit të bankës ndaj një personi.

NËNKREU II
MBIKËQYRJA E KONSOLIDUAR

Neni 82
Grupi bankar

1. Banka e Shqipërisë ushtron mbikëqyrjen e grupeve bankare dhe të grupeve financiare mbi bazat e pasqyrave të konsoliduara financiare dhe të raporteve mbikëqyrëse.

2. Institucion i varur është çdo subjekt që bën pjesë në të njëjtin grup bankar ose financiar, që nuk konsiderohet institucion mbizotërues, veprimtaria e të cilit përfshihet për efekt të kryerjes së mbikëqyrjes së konsoliduar.

3. Si përjashtim i pikës 43 të nenit 4 të këtij ligji, institucion mbizotërues, sipas kuptimit të këtij neni, konsiderohet gjithashtu një bankë ose një subjekt tjetër financiar jobankë i licencuar nga Banka e Shqipërisë, në rastet kur Banka e Shqipërisë vlerëson që banka ose subjekti tjetër financiar jobankë i licencuar ushtron një ndikim të konsiderueshëm mbi një institucion tjetër financiar mbi baza të tjera.

4. Banka e Shqipërisë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet kompetente mbikëqyrëse vendase ose të një shteti tjetër, të cilat janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e bankës së huaj ose

institucionit financiar, që është pjesë e një grupi bankar ose e një grupi financiar që vepron në Republikën e Shqipërisë, ose anasjelltas, në mënyrë që të përcaktojnë fushën e veprimit dhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes së konsoliduar të veprimeve të bankës, të grupit bankar ose të shoqërisë financiare zotëruese.

5. Aksionerët me pjesëmarrje influencuese, si dhe administratorët e bankës mbizotëruese në një shoqëri financiare zotëruese, i nënshtrohen përkatësisht dispozitave të krerëve II dhe III të këtij ligji në lidhje me kushtet kualifikuese dhe skualifikuese të tyre.

Neni 83

Përgjegjësitë e një banke mbizotëruese në një grup bankar

Për qëllime të mbikëqyrjes së konsoliduar, sipas këtij ligji, banka mbizotëruese në një grup bankar është përgjegjëse për përmbushjen e kërkesave për raportimin e konsoliduar të grupit bankar në tërësi.

Neni 84

Administrimi i rrezikut në një grup bankar

1. Dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, që lidhen me rregullat e administrimit të rrezikut, zbatohen edhe për grupin bankar në tërësi.
2. Një grup bankar organizohet në një mënyrë të tillë që një bankë mbizotëruese në një grup bankar të jetë e aftë të monitorojë rreziqet, me të cilat një grup bankar është i ekspozuar dhe të zbatojë masat për administrimin e këtyre rreziqeve.
3. Një grup bankar në tërësi përcakton pozicionin e konsoliduar të:

a) kapitalit rregullator;
b) mjaftueshmërisë së kapitalit;
c) ekspozimet ndaj rrezikut;
ç) pozicioneve të hapura valutore;
d) investimeve në kapitalin e institucioneve jofinanciare.

Neni 85

Konsolidimi i pasqyrave financiare të një grupi bankar

1. Një bankë mbizotëruese në një grup bankar përgatit dhe i paraqet Bankës së Shqipërisë pasqyrat e konsoliduara financiare.
2. Pasqyrat e konsoliduara financiare të një grupi bankar përgatiten në bazë pasqyrash individuale financiare të anëtarëve të grupit, të hartuara në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin” dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.
3. Banka e Shqipërisë përcakton me akte nënligjore fushën e zbatimit të mbikëqyrjes së konsoliduar, shpeshtësinë e konsolidimit, si edhe përmbajtjen e pasqyrave të konsoliduara financiare.
4. Banka e Shqipërisë urdhëron një bankë në një grup bankar që të kryejë konsolidimin e zërave të veçantë ose të operacioneve të veçanta, apo të një grupi operacionesh brenda grupit bankar, nëse kjo është e nevojshme për paraqitjen e plotë dhe objektive të pozicionit financiar dhe rezultatit operativ të grupit bankar në tërësi ose një banke të veçantë në grupin bankar.

Neni 86

Konsolidimi në rastet e tjera

1. Kur një grup bankar, siç përcaktohet në këtë ligj, nuk mund të identifikohet, Banka e Shqipërisë urdhëron një bankë, në të cilën një person juridik, i cili nuk është bankë ose shoqëri financiare zotëruese, ka pjesëmarrje influencuese ose ushtron kontroll, që të kryejë konsolidimin e veprimeve individuale ose grupveprimeve apo konsolidimin e plotë të pasqyrave financiare të të gjithë anëtarëve të grupit, pavarësisht nga veprimtaria e tyre, nëse kjo është e nevojshme për paraqitjen e plotë dhe objektive të pozicionit financiar dhe rezultateve operuese të bankës.

2. Banka e Shqipërisë mund të udhëzojë një bankë, e cila është institucion mbizotërues i një personi juridik që nuk është një bankë ose shoqëri financiare zotëruese, që të kryejë konsolidimin e veprimeve individuale ose grupveprimeve apo konsolidimin e plotë të pasqyrave financiare të të gjithë anëtarëve të grupit, pavarësisht nga veprimtaria e tyre, nëse kjo është e nevojshme për paraqitjen e plotë dhe objektive të pozicionit financiar dhe rezultateve operuese të bankës.
3. Personat juridikë të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni i paraqesin bankës të gjitha

informacionet e kërkuara për konsolidimin e veprimeve ose grupveprimeve apo konsolidimin e plotë të pasqyrave financiare të grupit, të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Banka njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë nëse personat juridikë të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk i paraqesin asaj të gjitha informacionet e kërkuara për konsolidimin.

Neni 87

Njoftimi i Bankës së Shqipërisë dhe dhënia e informacionit

1. Banka mbizotëruese njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë për të gjitha faktet dhe rrethanat e reja, të cilat janë të rëndësishme për të vlerësuar nëse ekziston grupi bankar, siç përcaktohet nga ky ligj.

2. Banka njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë për të gjitha institucionet e varura dhe mbizotëruese, të cilat përbëjnë një grup, pavarësisht nga veprimtaria e tyre.

3. Me përfundimin e vitit kalendarik, një bankë mbizotëruese në një grup bankar i paraqet Bankës së Shqipërisë informacionet e fundit për institucionet e varura ose mbizotëruese në grupin bankar, si edhe informacionet për institucionet e varura dhe mbizotëruese, të cilat përbëjnë një grup, pavarësisht nga veprimtaria e tyre.

4. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor përmbajtjen e njoftimit të parashikuar në këtë nen, si edhe kushtet dhe afatet për dorëzimin e këtij njoftimi.

Neni 88

Dorëzimi i të dhënave

1. Institucionet e varura në një grup bankar i dorëzojnë bankës mbizotëruese të gjitha të dhënat dhe informacionet e kërkuara prej tij për qëllime konsolidimi dhe sigurojnë procedurat e duhura të brendshme të kontrollit për verifikimin e saktësisë së këtyre të dhënave dhe informacioneve.

2. Personat juridikë që bëjnë pjesë në grup i dorëzojnë bankës së tyre mbizotëruese informacione për pjesëmarrjen e tyre në persona të tjerë, të rëndësishme për të përcaktuar nëse banka mbizotëruese ka detyrimin që të kryejë konsolidimin.

3. Banka mbizotëruese në një grup bankar siguron që institucionet e varura në grupin bankar dhe personi juridik, i cili ka pjesëmarrje influencuese ose ushtron kontroll mbi të, i paraqesin asaj të dhënat e kërkuara për konsolidimin. Nëse personi juridik, i cili ka pjesëmarrje influencuese ose ushtron kontroll mbi të nuk i dorëzon bankës mbizotëruese të dhënat e nevojshme për konsolidimin, banka njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë.

NËNKREU III
SANKSIONET

Neni 89

Masa ndëshkimore

1. Banka e Shqipërisë, për bankën ose degën e bankës së huaj, krahas masave të parashikuara në nenet 75, 79 dhe 81 të këtij ligji, urdhrave për eliminimin e shkeljeve të konstatuara, ka të drejtë të vendosë një ose disa masa ndëshkimore, pavarësisht nga renditja e tyre, si më poshtë:

a) vendos gjoba për administratorët e bankës ose degës së bankës së huaj;

b) jep vërejtje me paralajmërim me shkrim për administratorët e bankës ose degës së bankës së huaj.

2. Banka e Shqipërisë gjobit administratorët e bankës ose degës së bankës së huaj nga 2 000 000 – 2 500 000 lekë kur konstaton:

shkelje të dispozitave të neneve 7 dhe 22 të këtij ligji;

se banka ose dega e bankës së huaj ushtron veprimtari bankare ose financiare të papërfshira në aneksin e licencës;

se banka nuk ka marrë miratimin e Bankës së Shqipërisë për të hapur degë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ç) shkelje të dispozitave të neneve 24, 25, 26 pika 1, 55, 64, 65 dhe 70 të këtij ligji;

d) se nuk ka krijuar rezervat, sipas përcaktimeve të neneve 67 dhe 68 të këtij ligji;

dh) se nuk ka ruajtur nivelin e duhur të kapitalit rregullator.

Banka e Shqipërisë gjobit administratorët e bankës ose degës së bankës së huaj nga 500 000 – 800 000 lekë kur konstaton:

shkelje të dispozitave të neneve 26 pika 2, 41, 47, 48, 52 dhe 53 të këtij ligji;

shkelje të rregullave që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm;

se nuk janë marrë masat përkatëse për eliminimin e shkeljeve, ose nuk i merr sipas afateve të

përcaktuara.

4. Kur shkeljet përsëriten, Banka e Shqipërisë vendos dyfishimin e sanksioneve të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, si dhe mund:

a) të pezullojë deri në dymbëdhjetë muaj administratorët;

b) të kërkojë largimin e një ose të të gjithë administratorëve nga vendi i punës;

c) të urdhërojë ndërprerjen e shpërblimit të administratorëve nga banka ose dega e bankës së huaj;

ç) të vendosë bankën në kujdestari;

d) të revokojë licencën e bankës ose degës së bankës së huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë;

dh) të vendosë bankën ose degën e bankës së huaj në likuidim.

5. Në rastet kur banka ose dega e bankës së huaj nuk zbaton një ose më shumë nga masat ndëshkimore të mësipërme për përmirësimin e situatës së bankës ose degës së bankës së huaj apo korrigjimin e shkeljeve, Banka e Shqipërisë përshkallëzon masat ndëshkimore.

6. Kur raporti ndërmjet kapitalit rregullator të bankës dhe aktiveve të saj me rrezik dhe zërave jashtë bilancit është më shumë se gjysma e raportit minimal të kërkuar, por më pak se raporti minimal i kërkuar, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, përveç masave dhe dënimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, Banka e Shqipërisë u kërkon aksionerëve të rregullojnë situatën brenda periudhës kohore jo më të gjatë se gjashtë muaj.

7. Në rast se me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 6 të këtij neni, raporti ndërmjet kapitalit rregullator të bankës dhe aktiveve të saj me rrezik dhe zërave jashtë bilancit është më pak se raporti minimal i kërkuar, Banka e Shqipërisë vendos bankën në kujdestari, sipas dispozitave të nenit 96 të këtij ligji.

8. Banka e Shqipërisë njofton bankën ose degën e bankës së huaj, si dhe personat përgjegjës për çdo masë ndërshkimore të dhënë brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit të saj.

9. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë përcakton autoritetin përkatës (organin përfaqësues) në Bankën e Shqipërisë për nxjerrjen e akteve në lidhje me masat e mësipërme.

Neni 90

Ushtrimi i palicencuar i veprimtarisë

1. Ushtrimi i veprimtarisë bankare ose i çdo veprimtarie tjetër financiare, të parashikuar në nenet 4 dhe 54 të këtij ligji, pa licencë të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, përbën krim dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

2. Kur nga veprimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni u janë shkaktuar pasoja të rënda interesave të shtetasve ose atyre shtetërore, kryerja e veprimit dënohet me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet.

Neni 91

Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional

Administratorët, të punësuarit dhe agjentët aktualë e të mëparshëm të bankës ose degës së bankës së huaj, autoritetet gjyqësore, si dhe inspektorët apo nëpunësit e tjerë të Bankës së Shqipërisë ose të autoriteteve respektive të huaja të mbikëqyrjes bankare, për çdo informacion që marrin gjatë ushtrimit të veprimtarisë në bankë ose në degën e bankës së huaj, ruajnë sekretin dhe nuk e përdorin atë për përfitime vetjake ose për të tretët jashtë bankës ose degës së bankës së huaj, të cilave u shërbejnë ose u kanë shërbyer.

Informacioni i përshkruar në pikën 1 të këtij neni mund t'i jepet vetëm Bankës së Shqipërisë, ekspertit kontabël të autorizuar të bankës ose degës së bankës së huaj, administratorëve, agjentëve, nëpunësve të çdo sistemi informacioni ose shërbimi zyrtar të parashikuar në nenin 23 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", autoriteteve juridike që e fitojnë këtë të drejtë me ligj, si dhe kur e kërkon mbrojtja e interesave të bankës ose degës së bankës së huaj në procedurat ligjore.

Çdo shkelje e dispozitave të këtij neni përbën kundërvajtje penale. Personat fajtorë dënohen me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Kur kjo vepër kryhet me qëllim fitimi ose për të dëmtuar një person tjetër, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 92

Dëgjimi i subjektit të interesuar

Banka e Shqipërisë, para nxjerrjes së aktit administrativ, i jep subjektit, ndaj të cilit propozohet marrja e masës, të drejtën për t'u shprehur me shkrim brenda 5 ditëve, në lidhje me marrjen e masës së propozuar.

Neni 93
Ankimi administrativ dhe gjyqësor

Çdo subjekt i cenuar nga një akt administrativ i Bankës së Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë shfuqizimin ose ndryshimin e këtij akti nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë brenda 15 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose nga data e publikimit të tij.

Realizimi i ankimit administrativ te Guvernatori është kusht i domosdoshëm për ezaurimin e rekursit administrativ dhe për t'i dhënë mundësi subjektit të cenuar për t'iu drejtuar gjykatës.

Ankimi administrativ, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk e pezullon zbatimin e aktit administrativ të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë në rastet kur kjo e fundit çmon se interesat e depozituesve dhe siguria apo stabiliteti i sistemit bankar dhe atij financiar në tërësi mund të cenohen apo rrezikohen nga efekti pezullues i ankimit.

Ankimi administrativ paraqitet në formë shkresore dhe duhet të shprehë shkaqet për të cilat ankimohet akti administrativ, si dhe duhet të ketë të bashkëlidhur një kopje të aktit.

Në të gjitha ato raste kur Banka e Shqipërisë çmon se zbatimi i menjëhershëm i aktit administrativ i shërben interesave të sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit financiar në tërësi, ajo mund ta kushtëzojë fillimin e procedurës së ankimit administrativ me ofrimin nga ana e shtetasve ose subjekteve juridike të cenuara të garancive juridike të përshtatshme për ekzekutimin paraprak dhe të menjëhershëm të aktit administrativ.

6. Në çdo rast të ankimimit gjyqësor, ndaj pretendimeve të ngritura ndaj një vendimi të marrë nga Banka e Shqipërisë, gjykata e apelit vendos vetëm nëse Banka e Shqipërisë ka vepruar ose jo në mënyrë arbitrare apo të pakujdesshme.

Neni 94
Përgjegjësia civile ose penale

Masat ndëshkimore dhe dënimet e parashikuara në nenin 89 të këtij ligji nuk përjashtojnë përgjegjësinë civile ose penale të përcaktuar në akte të tjera ligjore.

Neni 95
Arkëtimi i gjobave

Gjobat e vendosura, sipas nenit 89 të këtij ligji, arkëtohen për llogari të Bankës së Shqipërisë.

KREU VII
KUJDESTARIA DHE LIKUIDIMI

NËNKREU I
KUJDESTARIA

Neni 96
Vendosja e bankës në kujdestari

Banka e Shqipërisë vendos bankën në kujdestari, me qëllim rikthimin e saj në një gjendje të shëndoshë financiare, në rastet kur:

raporti ndërmjet kapitalit rregullator të bankës dhe aktiveve të saj me rrezik dhe zërave jashtë bilancit është më pak se gjysma e raportit minimal të kërkuar, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë dhe pasi ajo u ka kërkuar aksionerëve të marrin masa për të rregulluar situatën brenda një periudhe jo më shumë se gjashtë muaj dhe banka nuk ka zbatuar ose nuk ka filluar të zbatojë këto masa;

pavarësisht se ka filluar zbatimi i masave mbikëqyrëse të përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike, banka nuk ka arritur nivelin e kërkuar të aftësisë paguese të saj; dhe

veprimtaria e mëtejshme e bankës rrezikon likuiditetin ose aftësinë paguese të saj.

Në vendimin e Bankës e Shqipërisë për vendosjen e bankës në kujdestari, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen:

arsyet për të cilat merret vendimi;

periudha kohore e zgjatjes së procesit të kujdestarisë, që nuk mund të jetë më shumë se 12 muaj;

detyrat kryesore të kujdestarit.

Vendimi i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe në një ose më shumë gazeta kombëtare. Banka e Shqipërisë e dërgon vendimin në bankën për të cilën është marrë vendimi, si dhe në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

Vendimi i Bankës së Shqipërisë për vendosjen e kujdestarisë përfshihet edhe në regjistrin për konsultim nga publiku që mbahet në Bankën e Shqipërisë, sipas nenit 128 të këtij ligji.

Neni 97
Efektet juridike të kujdestarisë

1. Gjatë periudhës së kujdestarisë pezullohen të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat e organeve drejtuese të bankës, si dhe të aksionerëve të bankës. Ky pezullim fillon nga data e marrjes së njoftimit për vendimin e Bankës së Shqipërisë lidhur me kujdestarinë.

2. Banka e Shqipërisë udhëzon kujdestarin e emëruar për administrimin e bankës, sipas akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

Neni 98
Emërimi i kujdestarit

Banka e Shqipërisë emëron kujdestarin, që do të marrë në kujdestari bankën, si dhe përcakton kompetencat e tij në vendimin e saj për vendosjen e bankës në kujdestari, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

Kujdestari gëzon të gjitha pushtetet e administratorëve, të drejtuesve ekzekutivë dhe të personelit të bankës, në përputhje me kompetencat e dhëna nga Banka e Shqipërisë në aktin e emërimit.

Paga e kujdestarit dhe shpenzimet për ushtrimin e funksioneve të tij përcaktohen nga Banka e Shqipërisë dhe përballohen nga banka, e cila është vendosur në kujdestari.

Neni 99
Kushtet kualifikuese të kujdestarit

1. Për të ushtruar funksionin e kujdestarit, sipas nenit 98 të këtij ligji, kandidati duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

të përmbushë kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për administratorët e bankës ose degës së bankës së huaj;

të ketë përvojë pune, të paktën 5-vjeçare, si drejtues ekzekutiv në një institucion financiar apo bankë ose në një shoqëri të ekspertëve kontabël të autorizuar.

2. Përpara emërimit të tij, personi i propozuar si kujdestar i bankës depoziton një vërtetim, në të cilin shprehet se ndaj tij nuk ka ndonjë ndalesë të përmendur në nenin 100 të këtij ligji.

Neni 100
Kushtet skualifikuese të kujdestarit

1. Nuk emërohet si kujdestar personi, i cili:

është dënuar penalisht nga gjykata për një vepër penale që ligji parashikon dënimin me burgim;

në çastin e emërimit të tij ka dyshime të bazuara për pjesëmarrje të tij në veprimtari mashtruese, apo i kërkohet dëmshpërblim që mund të privojë ose të cenojë materialisht mundësitë e tij për të realizuar detyrën;

është subjekt i hetimeve për veprimtari mashtruese ose vepra të tjera penale;

ç) me vendim të gjykatës është në pamundësi të ushtrojë detyrat ndaj bankës;

d) ka konflikt interesi me bankën, sipas nenit 114 të këtij ligji.

2. Në rast se Banka e Shqipërisë vëren se kujdestari i miratuar prej saj nuk i përmbush cilësitë dhe nuk zbaton kërkesat dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj, ajo e shkarkon këtë person.

Neni 101
Kompetencat dhe detyrat e kujdestarit

1. Kujdestari i emëruar nga Banka e Shqipërisë, me emërimin e tij, merr bankën në kujdestari dhe:

dërgon në çdo zyrë të bankës një njoftim për publikimin e këtij emërimi, duke përcaktuar datën dhe kohën kur hyn në fuqi kujdestaria e bankës;

boton njoftimin në një ose më shumë gazeta kombëtare;

dërgon menjëherë kopje të njoftimit të përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike në Bankën e Shqipërisë dhe në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

2. Kujdestarit i njihen të njëjtat të drejta, detyrime, kufizime dhe kushte që zbatohen për administratorët dhe personelin e bankës.

3. Administratorët e bankës vënë në dispozicion të kujdestarit të gjithë dokumentacionin e bankës dhe përgatisin një raport për gjendjen e saj, të cilin ia paraqesin kujdestarit. Me kërkesë të kujdestarit, ata japin

informacion me shkrim dhe raporte shtesë për veprimtarinë e bankës.

4. Kujdestari ka të drejtë të shkarkojë çdo person që refuzon të japë informacionin e kërkuar sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Kujdestari, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të tij, merr në dorëzim të gjithë inventarin e aktiveve dhe të pasurive të bankës, si dhe të gjithë dokumentacionin e arkivës. Dorëzimi i tyre bëhet me procesverbal të nënshkruar nga personat përgjegjës, nga administratorët dhe nga nëpunësit e pezulluar të bankës, si dhe nga kujdestari.

6. Menjëherë me emërimin e tij, kujdestari merr të gjitha masat për ruajtjen e aktiveve të bankës, duke ndërmarrë të paktën veprimet e mëposhtme:

a) ndryshon rregullin e hyrjes në ndërtesat dhe në mjediset ku ruhen pasuritë, dokumentacioni, informacioni, pajisjet, përdorimi i të cilave dëmton interesat pasurorë të bankës, duke zëvendësuar kodet dhe fjalëkalimet dhe duke vendosur kufizime të rrethit të personave që kanë të drejtë të hyjnë në këto mjedise;

b) ndryshon ose krijon fjalëkalime të reja për hyrjet në rrjetin kompjuterik, duke lejuar hyrjen në të vetëm të një numri të kufizuar të punonjësve të besuar; lëshon lloje të reja të kartave të kalimit për hyrjet në mjediset e bankës për punonjësit e autorizuar dhe kontrollon hyrjet e punonjësve të tjerë në këto mjedise;

c) pezullon ushtrimin e kompetencave të personave, të cilët mund të ushtrojnë veprimtari në emër dhe për llogari të bankës dhe autorizon një numër të caktuar punonjësish dhe për këto ndryshime njofton palët e treta;

ç) informon bankat korrespondente, agjentët e letrave me vlerë dhe personat që administrojnë aktivet dhe regjistrat në emër të bankës se të gjitha autorizimet e dhëna nga banka deri në emërimin e tij janë pezulluar dhe autorizimet do t'i jepen një numri të kufizuar personash, për emrat e të cilëve ata informohen;

d) ndalon pagesën e dividentëve ose shpërndarjen e kapitalit për aksionerët, si dhe pagesën e administratorëve, përveç shpërblimit për shërbimet që ata kanë bërë në bankë.

7. Me emërimin e tij, kujdestari:

organizon punën për kthimin në gjendje normale të bankës. Për këtë qëllim ai kryen të paktën një nga veprimet e mëposhtme:

i) riklasifikon cilësinë e aktiveve;

ii) përqendron veprimtarinë e bankës në veprimtari pa rrezik (blerje bonosh thesari ose letrash të tjera me vlerë me rrezik zero), vendosje në banka të vlerësuara "shkëlqyeshëm" ose "shumë mirë" nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut dhe të tjera veprimtari të ngjashme me këto;

iii) evidenton pjesën e aktiveve të këqija (nonperforming assets), duke cilësuar brenda tyre kreditë me probleme dhe merr masa për ekzekutimin e detyrimeve;

harton dhe i paraqet Bankës së Shqipërisë një plan për rikapitalizimin e bankës pas veçimit të aktiveve të këqija, në të cilin vlerëson nëse rikapitalizimi i bankës është më i përshtatshëm dhe mbron më mirë interesat e bankës, depozituesve dhe kreditorëve sesa kalimi në likidim të detyruar;

mund t'i shesë një pjesë të aktiveve të këqija të bankës një banke tjetër;

ç) negocion në bashkëpunim me aksionerët për mundësinë e shkrirjes së bankës me një bankë tjetër ose shitjen e bankës së rikapitalizuar;

d) në pamundësi për realizimin e veprimeve të parashikuara në shkronjat "a" deri në "ç" të kësaj pike, i propozon Bankës së Shqipërisë fillimin e procedurave të likuidimit.

Gjatë periudhës në të cilën banka është vendosur në kujdestari, të gjitha transaksionet e kryera nga banka, pa autorizimin përkatës të kujdestarit të emëruar, nuk kanë vlefshmëri ligjore.

Kujdestari administron bankën në mënyrën më të mirë të mundshme për rikthimin e saj në gjendje të shëndetshme financiare.

Kujdestari është subjekt i akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

Kujdestari ka të drejtë të urdhërojë nëpunësit dhe administratorët për zbatimin e funksioneve të veçanta në bankë. Këta administratorë dhe nëpunës mund të shkarkohen nga kujdestari.

Në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, kujdestari ka të drejtë të veçojë dhe të sigurojë shumat e duhura monetare për t'u tërhequr nga depozituesit, si dhe për pagimin e detyrimit ndaj kreditorëve të tjerë. Të gjithë depozituesit dhe kreditorët, të cilët janë në kushte të barabarta, trajtohen në mënyrë të barabartë.

Neni 102

Raportimet e kujdestarit

Kujdestari raporton periodikisht në Bankën e Shqipërisë për ecurinë e procesit të kujdestarisë, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

të paktën një herë në muaj kujdestari i paraqet për miratim Bankës së Shqipërisë një raport për pozicionin financiar dhe kushtet operacionale të bankës gjatë procesit të kujdestarisë;

brenda gjashtë muajve nga vendosja e bankës në kujdestari, kujdestari paraqet një raport në Bankën e Shqipërisë për pozicionin financiar dhe kushtet operacionale të bankës gjatë kohës së kujdestarisë, së bashku me

vlerësimin e qëndrueshmërisë së bankës dhe mundësinë e operacioneve të metëjshme të saj, i cili përfshin:

i) vlerësimin e gatishmërisë së aksionerëve të bankës për të mbuluar humbjet e bankës nëpërmjet shtesave të fondeve;

ii) mundësinë e mbulimit të humbjeve të mbetura të bankës pas konsumimit të mundësisë, të parashikuar në shkronjën "i" të kësaj pike;

iii) shpenzimet e paparashikuara, të cilat kanë efekt në detyrimet e bankës;

iv) vlerësimin e masave të mundshme për të eliminuar vështirësitë financiare të bankës së bashku me vlerësimin e shpenzimeve për zbatimin e këtyre masave;

v) vlerësimin e kushteve për të filluar procedurat e likuidimit të bankës.

Gjatë përgatitjes së raporteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kujdestari angazhohet për mbrojtjen e interesave të depozituesve dhe të kredimarrësve.

Brenda 15 ditëve nga paraqitja e raporteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë vendos për miratimin ose jo të tyre. Në rast miratimi të raporteve, Banka e Shqipërisë urdhëron bankën për zbatimin e tyre.

Një kopje të raporteve të miratuara nga Banka e Shqipërisë, sipas përcaktimit të pikës 3 të këtij neni, kujdestari e dërgon në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

Neni 103

Rritja e kapitalit

Bazuar në raportet e paraqitura nga kujdestari, sipas nenit 102 të këtij ligji, Banka e Shqipërisë, kur e çmon të nevojshme, urdhëron kujdestarin të thërrasë asamblenë e aksionerëve të bankës dhe t'i kërkojë asaj rritjen e kapitalit.

Kujdestari detyrohet të thërrasë mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme të aksionerëve të bankës jo më vonë se 10 ditë pas marrjes së urdhrit të Bankës së Shqipërisë, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Në rast se refuzohet rritja e kapitalit themeltar, kujdestari vë në dijeni asamblenë e jashtëzakonshme të aksionerëve të bankës dhe banka kalon në procedurë likuidimi të detyruar.

Neni 104

Vlerësimi i rezultateve

Banka e Shqipërisë bën vlerësimin e rezultateve të kujdestarisë çdo 3 muaj, duke filluar nga data e marrjes së vendimit të kujdestarisë.

2. Banka e Shqipërisë harton një raport vlerësimi përfundimtar të kujdestarisë së bankës brenda 3 muajve nga marrja e raportit përfundimtar të kujdestarit, sipas nenit 105 pika 1 shkronja "a" të këtij ligji.

Neni 105

Përfundimi i kujdestarisë

1. Kujdestaria përfundon me:

mbarimin e afatit të parashikuar në vendimin e Bankës së Shqipërisë për vendosjen e bankës në kujdestari. Në këtë rast kujdestari, me përfundimin e funksioneve të tij, paraqet në Bankën e Shqipërisë një raport përfundimtar për t'u përgjigjur për gjithë procesin e kujdestarisë;

marrjen e një vendimi nga Banka e Shqipërisë për përfundimin e kujdestarisë përpara afatit të përfundimit të kujdestarisë, duke e konsideruar të rehabilituar bankën, bazuar në raportin e vlerësimit përfundimtar, sipas nenit 104 pika 2 të këtj ligji dhe nëse:

i) Banka e Shqipërisë vlerëson se gjendja financiare e bankës është përmirësuar gjatë periudhës së kujdestarisë;

ii) banka ka përmbushur të gjitha detyrimet e saj;

iii) banka mund të ushtrojë veprimtarinë e saj normalisht;

c) marrjen e një vendimi nga Banka e Shqipërisë për vendosjen e bankës në proces likudimi të detyruar, duke revokuar licencën, në qoftë se pozicioni financiar i bankës nuk është përmirësuar gjatë periudhës së kujdestarisë. Në këtë rast kujdestari, me përfundimin e funksioneve të tij, paraqet në Bankën e Shqipërisë një raport përfundimtar për t'u përgjigjur për gjithë procesin e kujdestarisë.

2. Vendimi i Bankës së Shqipërisë për rehabilitimin e bankës, sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni, shoqërohet edhe me një plan të hollësishëm rehabilitimi, të hartuar nga kujdestari, i cili duhet të identifikojë dobësitë ekzistuese në administrimin dhe operacionet e bankës, duke përcaktuar në detaje:

përgjëgjësitë e administratorëve;

masat korrektuese të kërkuara për përmirësimin e situatës; dhe

një plan financiar për rehabilitimin e propozuar të bankës.

NËNKREU II
LIKUIDIMI

Neni 106
Llojet e likuidimit

Banka ose dega e bankës së huaj, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, likuidohet në dy mënyra, si më poshtë:

me likuidim vullnetar; ose

me likuidim të detyruar.

Neni 107
Likuidimi vullnetar

Likuidimi vullnetar bëhet në rastet kur:

aksionerët e bankës ose vetë banka e huaj, në rastin e degës së bankës së huaj, vendosin vullnetarisht të kalojnë bankën në proces likuidimi. Në këtë rast banka ose dega e bankës së huaj njoftojnë paraprakisht për këtë vendim Bankën e Shqipërisë;

aksionerët e bankës ose vetë banka e huaj, në rastin e degës së bankës së huaj, vendosin për ndryshimin e veprimtarive të bankës ose degës së bankës së huaj, për të mos vazhduar me ushtrimin e veprimtarisë bankare.

Me paraqitjen e vendimit të likudimit vullnetar nga banka ose dega e bankës së huaj, Banka e Shqipërisë revokon licencën përkatëse dhe banka ose dega e bankës së huaj e depoziton këtë licencë pranë Bankës së Shqipërisë.

Vendimi i likuidimit vullnetar i dërgohet njëkohësisht edhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për të ushtruar kompetencat e saj në bazë të ligjit “Për sigurimin e depozitave”.

Në rast të marrjes së vendimit të bankës ose degës se bankës së huaj për kalimin në likudim vullnetar, me qëllim të mbrojtjes së interesave të klientëve të bankës, aksionerët e bankës ose vetë banka e huaj, në rastin e degës së bankës së huaj, duhet të shlyejnë të gjitha pretendimet e kreditorëve të tyre.

Vendimi i likuidimit vullnetar publikohet dhe botohet nga banka ose dega e bankës së huaj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në të paktën dy gazeta kombëtare.

Për likuidimin vullnetar zbatohen edhe dispozitat e ligjit “Për shoqëritë tregtare”, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 108
Rrethanat për vendosjen e likuidimit të detyruar

1. Banka e Shqipërisë vendos në likuidim të detyruar bankën ose degën e bankës së huaj kur konstaton ekzistencën e një ose më shumë rrethanave të tilla si:

bankës ose degës së bankës së huaj i është revokuar licenca për kryerjen e veprimtarive bankare dhe financiare, sipas dispozitave të këtij ligji;

banka ose dega e bankës së huaj nuk paguan detyrimet financiare të saj, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;

mjaftueshmëria e kapitalit të bankës, edhe pas kalimit të afateve të përcaktuara në nenin 96 të këtij ligji, vazhdon të jetë më pak se 50 për qind e raportit minimal të përcaktuar në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë;

ç) vlera e aktiveve të bankës ose degës së bankës së huaj është më pak se vlera e detyrimeve të saj;

banka nuk është në gjendje të përmbushë kërkesat e depozituesve të saj ose të paguajë detyrimet gjatë ecurisë normale të veprimtarisë tregtare të saj;

dh) gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së bankës ose degës së bankës së huaj konstatohet se aktivet janë të pamjaftueshme për të përmbushur detyrimet e kreditorëve;

kur pas përfundimit të afatit 12-mujor të kujdestarisë banka nuk është rimëkëmbur nga pikëpamja financiare;

ë) kur konkludohet nga Banka e Shqipërisë se likuidimi vullnetar mund të shkaktojë dëm në interesat e kreditorëve;

kur aksionerët e bankës ose banka e huaj, në rastin e degës së bankës së huaj, nuk pranojnë të investojnë për të rritur vlerën e kapitalit në kufijtë e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë;

g) kur ka prova të besueshme që administratorët e bankës ose degës së bankës së huaj janë përfshirë në

transaksione të jashtëligjshme, kanë kryer mashtrime të rënda, ose kanë përfituar personalisht dhe i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme bankës, degës së bankës së huaj ose personave të tretë;

gj) kur kreditorët e bankës ose degës së bankës së huaj vërtetojnë përpara Bankës së Shqipërisë se 10 për qind ose më shumë e detyrimeve të evidentuara nga bilanci kontabël më i fundit i bankës nuk i janë paguar brenda afatit. Në rast se Banka e Shqipërisë nuk ndërmerr veprimet e mësipërme, një ose më shumë persona të interesuar kanë të drejtë të kërkojnë nga gjykata kompetente të detyrojë Bankën e Shqipërisë të veprojë në përputhje me këtë paragraf.

2. Në rastin e degës së bankës së huaj, aktivet e përcaktuara në nenin 59 pika 7 të këtij ligji, bllokohen nga Banka e Shqipërisë kur:

autoriteti mbikëqyrës i vendit të origjinës vlerëson se banka e huaj rrezikon qëndrueshmërinë financiare dhe fillon ndaj saj procedurat e likuidimit; ose

ndaj degës së bankës së huaj konstatohet ekzistenca e një ose më shumë rrethanave, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 109

Vendimi për likuidimin e detyruar

1. Banka e Shqipërisë vendos bankën ose degën e bankës së huaj në proces likuidimi të detyruar menjëherë pas konstatimit të rrethanave përkatëse, për çdo rast të parashikuar në nenin 108 të këtij ligji.

2. Në vendimin e Bankës e Shqipërisë për vendosjen e bankës ose degës së bankës së huaj në likuidim të detyruar, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen:

arsyet për të cilat merret vendimi;

detyrat kryesore të likuidatorit;

emri i bankës ose degës së bankës së huaj;

ç) adresa e selisë qendrore;

emri i plotë i likuidatorit;

dh) data e fillimit të procesit të likuidimit;

revokimi i licencës.

3. Një kopje të vendimit për likuidimin e detyruar të bankës ose degës së bankës së huaj Banka e Shqipërisë e dërgon njëkohësisht edhe në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

Neni 110

Njoftimi për fillimin e procedurave të likuidimit të detyruar

1. Njoftimi për vendosjen e bankës ose degës së bankës së huaj në proces likuidimi, pas marrjes së vendimit përkatës nga Banka e Shqipërisë dhe për revokimin e licencës, botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në të paktën dy gazeta kombëtare.

2. Njoftimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni përmban:

kopjen e vendimit të Bankës së Shqipërisë për vendosjen e bankës ose degës së bankës së huaj në likuidim, sipas nenit 109 të këtij ligji;

ftesën për kreditorët, për të regjistruar pretendimet e tyre pranë likuidatorit;

ftesën për debitorët, për të shlyer menjëherë detyrimet e tyre.

Neni 111

Emërimi i likuidatorit

1. Banka e Shqipërisë emëron likuidatorin që do të marrë në posedim dhe në kontroll bankën ose degën e bankës së huaj gjatë procesit të likuidimit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

2. Banka e Shqipërisë emëron likuidatorin menjëherë pas vendosjes së bankës ose degës së bankës së huaj në likuidim.

3. Paga e likuidatorit dhe shpenzimet për ushtrimin e funksioneve të tij përballohen nga banka ose dega e bankës së huaj, e cila është vendosur në likuidim të detyruar.

Neni 112

Kushtet kualifikuese të likuidatorit

1. Për të ushtruar funksionin e likuidatorit, sipas nenit 111 të këtij ligji, kandidati duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

të përmbushë kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për administratorët e bankës ose degës së bankës së huaj;

të ketë përvojë pune, të paktën 5-vjeçare, si drejtues ekzekutiv në një institucion financiar ose bankë apo në një shoqëri të ekspertëve kontabël të autorizuar.

2. Përpara emërimit të tij, personi i propozuar si likuidator i bankës ose degës së bankës së huaj depoziton një vërtetim, në të cilin shprehet se ndaj tij nuk ka ndonjë ndalesë të përmendur në nenin 113 të këtij ligji.

Neni 113

Kushtet skualifikuese të likuidatorit

1. Nuk emërohet si likuidator një person, i cili:

është dënuar penalisht nga gjykata për një vepër penale që ligji parashikon dënimin me burgim;

në çastin e emërimit të tij ka dyshime të bazuara për pjesëmarrje të tij në veprimtari mashtruese, apo i kërkohet dëmshpërblim që mund të privojë ose të cenojë materialisht mundësitë e tij për të realizuar detyrën;

është subjekt i hetimeve për veprimtari mashtruese ose vepra të tjera penale;

ç) me vendim të gjykatës është në pamundësi të ushtrojë detyrat ndaj bankës ose degës së bankës së huaj.

ka konflikt interesi me bankën ose degën e bankës së huaj, sipas nenit 114 të këtij ligji.

2. Likuidatori i miratuar nga Banka e Shqipërisë zëvendësohet kur ai nuk zbaton në mënyrën e duhur detyrat e tij, ose kur ai nuk ka më legjitimitetin të shërbejë si likuidator. Kur një likuidator zëvendësohet, likuidatori i ri vazhdon të ushtrojë kompetencat e likuiditatorit të parë dhe atij i transferohen të gjitha aktivet, librat dhe llogaritë e bankës ose degës së bankës së huaj.

Neni 114

Konflikti i interesave

1. Përpara emërimit të kujdestarit ose likuidatorit nga Banka e Shqipërisë, personi i propozuar duhet të depozitojë pranë Bankës së Shqipërisë, sa më shpejt që të jetë e mundur, një informacion lidhur me konfliktin e interesave midis tij dhe bankës ose degës së bankës së huaj, për të cilën është marrë vendimi për likuidim të detyruar.

2. Informacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni përmban përshkrimin e interesave privatë, tregtarë dhe financiarë të personit të propozuar si likuidator ose bashkëshortit/bashkëshortes së tij/saj, si dhe të fëmijëve, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në informacionet e mëposhtme për:

hua ose kredi të marra në bankën ose degën e bankës së huaj, aktivet e së cilës janë përfshirë në likuidim;

marrëdhënie punësimi në bankën ose degën e bankës së huaj, aktivet e së cilës janë përfshirë në likuidim;

të drejta pronësie në bankë ose degën e bankës së huaj, aktivet e së cilës janë përfshirë në likuidim;

ç) marrëdhëniet e tij gjatë pesë vjetëve të fundit me çdo bankë tjetër si nëpunës apo punonjës ose si administrator apo drejtor ose aksioner me pjesëmarrje influencuese;

marrëdhëniet financiare, tregtare ose marrëdhëniet e ngushta financiare me çdo subjekt që ka pjesëmarrje në kapitalin e bankës ose degës së bankës së huaj që është objekt likuidimi, ose aktivet e së cilës janë objekt likuidimi, duke përfshirë informacionin për negocimet apo marrëveshjet e punësimit të pritshëm me këtë subjekt;

dh) listën dhe përshkrimin e çdo rasti që ai ka qenë në pamundësi për të shlyer çdo detyrim ndaj bankës ose degës së bankës së huaj gjatë pesë vjetëve të fundit;

të drejta pronësie për çdo pasuri në diskutim, në rast se personi i propozuar vlerëson, disponon ose administron një pasuri të paluajtshme;

ë) çdo veprimtari tjetër tregtare ose pjesëmarrje në kapitalin e një subjekti që ushtron veprimtari financiare, të cilat mund të cenojnë mundësinë e personit të veprojë në mënyrë të pavarur si likuidator;

f) çdo informacion tjetër që mund të kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

3. Personi i propozuar për likuidator vërteton se nuk ka konflikte interesi për shkak të marrëdhënieve familjare dhe tregtare brenda kohës së depozitimit të informacionit të përshkruar në pikën 4 të këtij neni. Në rast të vërtetimit të kushteve që konsiderohen si konflikt interesi midis personit të propozuar si likuidator dhe bankës ose degës së bankës së huaj, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, Banka e Shqipërisë nuk e miraton personin e propozuar si likuidator dhe ai njoftohet se është në pamundësi për të vepruar si i tillë.

4. Në rast se personi i emëruar si likuidator vihet në dijeni për konfliktin e interesave, njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë brenda dhjetë ditëve nga marrja dijeni për këto konflikte dhe parashtron masat që ka marrë ose do të marrë për mënjanimin e tyre. Banka e Shqipërisë merr masat për të bërë ndryshimet përkatëse.

5. Likuidatori i emëruar nga Banka e Shqipërisë nuk duhet:

të pranojë ose të kërkojë përfitime, dhurata ose sende të tjera me vlerë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga çdo subjekt:

i) për të cilin ai është në dijeni se mund t'i kërkojë ndërhyrje lidhur me procesin e likuidimit; ose

ii) i cili ka interesa materialë që mund të cenohen në mënyrë thelbësore nga kryerja ose moskryerja e detyrave;

b) të përdorë në mënyrë të papërshtatshme ose të lejojë përdorimin në mënyrë të papërshtatshme të pasurisë së tij ose pasurinë që ai e mbikëqyr apo e kontrollon, për përfitime vetjake të çdo subjekti tjetër;

c) të bëjë çdo premtim ose veprim të paautorizuar.

Neni 115

Pavarësia dhe ruajtja e konfidencialitetit nga likuidatori

1. Likuidatori është i pavarur në ushtrimin e detyrave të tij gjatë procesit të likuidimit të bankës ose degës së bankës së huaj.

2. Likuidatori respekton të gjitha kërkesat për ruajtjen e sekretit profesional, si dhe të sekretit të informacionit për klientin, të përcaktuara në nenet 91 dhe 125 të këtij ligji.

Neni 116

Efektet juridike të likuidimit

1. Me vendosjen e bankës ose degës së bankës së huaj në likuidim të detyruar dhe me emërimin e likuidatorit, ndërmerren këto veprime:

Banka e Shqipërisë revokon licencën e bankës ose të degës së bankës së huaj;

likuidatori bëhet përfaqësuesi i vetëm ligjor i bankës ose i degës së bankës së huaj dhe të gjitha pretendimet kundrejt tyre i drejtohen likuidatorit;

të gjitha procedurat gjyqësore kundër bankës ose degës së bankës së huaj pezullohen dhe këto procedura nuk fillojnë, me përjashtim të lejes së dhënë nga Banka e Shqipërisë dhe të kushteve të tilla që vendos Banka e Shqipërisë;

ç) nuk realizohet asnjë pagesë interesi ose pagesa të tjera të borxheve të bankës ose të degës së bankës së huaj;

transferimi i aksioneve të bankës ose të degës së bankës së huaj konsiderohet i pavlefshëm, me përjashtim të rasteve të dhënies së pëlqimit nga Banka e Shqipërisë;

dh) çdo kusht ligjor, kontraktual ose i çfarëdoshëm, me mbarimin e afatit të të cilit një detyrim i pretenduar ose një e drejtë e bankës ose e degës së bankës së huaj mund të shuhet ose të ngurtësohet, duhet të rivendoset në afat deri në gjashtë muaj nga data e mbarimit të afatit ose të ngurtësimit;

e) shfuqizohet çdo sekuestro, barrë ose peng, përveç sekuestros, barrës ose pengut të vendosur gjashtë muaj përpara vendosjes së bankës në likuidim. Për aq kohë sa procedura e likuidimit vazhdon, asnjë sekuestro, barrë, peng ose titull ekzekutiv, në zbatim të vendimit gjyqësor të marrë përpara datës së emërimit të likuidatorit, për një shumë në masën e parashikuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë, nuk vendoset mbi çdo aktiv ose pronë të bankës ose degës së bankës së huaj;

ë) të drejtat e aksionerëve ngurtësohen, përveç të drejtave për të përfituar dividentët nga procedura e likuidimit;

f) të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese të bankës ose degës së bankës së huaj, si dhe të drejtat e aksionerëve përfundojnë;

g) fillohen procedurat për kompensimin e depozitave, në përputhje me ligjin “Për sigurimin e depozitave”.

2. Kur pagesa ose transferta e bankës ose e degës së bankës së huaj bëhet për qëllim preferimi për përfituesin e saj, ajo prezumohet si e tillë, përveç rasteve të mëposhtme:

a) pagesa është bërë nga banka ose dega e bankës së huaj për kreditorin gjatë ushtrimit të veprimtarisë normale tregtare, për të shlyer plotësisht ose pjesërisht një borxh ose ndonjë detyrim tjetër të bankës ndaj përfituesit;

b) transferta e një aktivi ose pasurie është bërë nga banka ose dega e bankës së huaj si shkëmbim në kompesim të një vlere të barabartë me vlerën e vërtetë të aktiveve në treg ose të pasurisë së transferuar; ose

c) transferta është kryer për pjesën e siguruar të depozitave.

3. Çdo pagesë ose transfertë e ndonjë aktivi ose pronë e bankës apo e degës së bankës së huaj, si dhe pagesat e parashikuara në shkronjën “ç” të pikës 2 të këtij neni janë absolutisht të pavlefshme dhe nuk zbatohen kur janë kryer:

brenda periudhës tremujore, përpara se likuidatori ka vendosur posedimin dhe kontrollin mbi bankën; ose

për një person juridik të lidhur me bankën ose degën e bankës së huaj, brenda periudhës 12-mujore, përpara se likuidatori të ketë vendosur posedimin mbi bankën, kjo me qëllim preferencimi të përfituesit ndaj kreditorëve të tjerë të bankës. Bëjnë përjashtim nga ky rregull pagesat e depozitave bankare në shumat e parashikuara me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.

4. Personat që kërkojnë deklarimin e transaksionit si absolutisht të pavlefshëm dhe të pazbatueshëm, për shkaqet e parashikuara në këtë pikë, janë të detyruar të vërtetojnë që pagesa ose transferta ishte bërë për të realizuar preferencën siç e kërkon kjo pikë.

5. Transfertat, të cilat kanë filluar dhe kanë hyrë në sistemin e transfertave pas vendosjes së bankës në proces likuidimi dhe të cilat kanë vepruar në datën e marrjes së vendimit të likuidimit, janë të zbatueshme përderisa marrësi nuk provon që sistemi operator i transfertave ka qenë në dijeni të vendimit të likuidimit përpara se urdhri të bëhej i formës së prerë.

6. Likuidatorit dhe personave të emëruar për të përfaqësuar ose ndihmuar atë nuk mund t'u paguhen shuma më të mëdha se ato që u janë paguar punonjësve të bankës ose degës së bankës së huaj për shërbime të ngjashme të kryera prej tyre.

Neni 117

Detyrat dhe kompetencat e likuidatorit

1. Likuidatori i emëruar nga Banka e Shqipërisë zbaton detyrat e tij nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë.

2. Likuidatori përfaqëson bankën ose degën e bankës së huaj gjatë procesit të likuidimit të detyruar.

3. Likuidatori nënshkruan në të gjitha aktet e dokumentet e nxjerra nga banka ose dega e bankës së huaj, të cilat përmbajnë emërtimin e saj, duke u shoqëruar nga shënimi “bankë” ose “degë e bankës së huaj” “në likuidim të detyruar”.

4. Likuidatori i emëruar nga Banka e Shqipërisë, brenda tri ditëve nga data e emërimit të tij, merr në posedim dhe në kontroll bankën ose degën e bankës së huaj.

5. Likuidatori i emëruar nga Banka e Shqipërisë, brenda tri ditëve nga dita e emërimit të tij, vendos bankën ose degën e bankës së huaj në likuidim dhe:

dërgon në çdo zyrë të bankës ose degës së bankës së huaj një njoftim për publikimin e këtij emërimi, duke përcaktuar datën dhe kohën kur hyn në fuqi likuidimi i bankës ose i degës së bankës së huaj;

publikon njoftimin në një ose më shumë nga gazetat kombëtare;

dërgon menjëherë kopje të njoftimit të përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike në Bankën e Shqipërisë dhe në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

6. Likuidatori ka pushtet të plotë dhe ekskluziv për administrimin, drejtimin dhe kontrollin e bankës.

7. Likuidatori ka pushtet të plotë dhe ekskluziv për administrimin, drejtimin dhe kontrollin e degës së bankës së huaj dhe të të gjitha aseteve të degës së bankës së huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. Likuidatori synon sigurimin e shumës maksimale të aktiveve të bankës ose degës së bankës së huaj, pavarësisht se licenca e bankës është revokuar, duke ndërmarrë veprime si më poshtë:

a) vazhdon ose ndërpret çdo transaksion bankar ose financiar;

b) merr hua mjete monetare, duke vendosur ose jo masën e sigurisë mbi aktivet e bankës ose degës së bankës së huaj;

c) ndalon ose kufizon pagimin e çdo detyrimi, sipas kushteve të përshkruara në shkronjën “dh” të kësaj pike;

ç) rivendos përqindjet e interesave të ripagueshme të pasiveve të bankës ose degës së bankës së huaj, me kusht që këto përqindje të mos jenë më të ulëta se përqindjet mbizotëruese në tregun përkatës;

d) punëson çdo nëpunës, punonjës ose këshilltar profesionist të domosdoshëm;

dh) ekzekuton çdo instrument në emër të bankës ose degës së bankës së huaj, ngre padi ose mbron dhe ndjek në emër të tij çdo veprim ose procedurë ligjore, pasi ka marrë më parë miratimin e Bankës së Shqipërisë, për ndërmarrjen e veprimeve të mëposhtme:

i) shitjen e çdo aktivi të bankës ose degës së bankës së huaj që ka vlerë mbi një kufi të parashikuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë;

ii) vendosjen e masës së sigurisë, si mjet për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit, mbi çdo aktiv të bankës ose degës së bankës së huaj në favor të kreditorit, i cili ka dhënë një kredi të re për subjektin në vlerën që kalon shumën e parashikuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë;

iii) ristrukturimin ose faljen e çdo detyrimi të pretenduar, në rast se vlera e detyrimit të pretenduar kalon shumën e parashikuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë;

iv) pagesën e çdo detyrimi të pretenduar dhe të njohur sipas dispozitave të këtij ligji, në të cilin të gjithë

depozituesit dhe kreditorët në pozita të barabarta duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë.

9. Likuidatori ka të drejtë të përfundojë:

a) kontratat e punësimit në bankë ose degën e bankës së huaj me çdo person;

kontrata shërbimesh, në të cilat banka ose dega e bankës së huaj është palë;

çdo detyrim, ku banka ose dega e bankës së huaj është qiramarrës i pasurisë së paluajtshme.

10. Brenda dy muajve nga data e emërimit të tij, likuidatori:

ndërmerr veprimet e domosdoshme për të zgjidhur të gjitha marrëdhëniet e besimit të kryera nga banka ose dega e bankës së huaj, për t'u kthyer aksionerëve të gjitha aktivet dhe pasuritë e poseduara nga banka ose dega e bankës së huaj, mbi bazën e marrëdhënieve të besimit, si dhe të mbyllë llogarinë kontabël të këtyre marrëdhënieve të besimit;

dërgon me postë rekomande, sipas adresave në regjistrat e bankës ose degës së bankës së huaj, tek të gjithë depozituesit, kreditorët e tjerë, klientët e shërbimeve të arkës kasafortë dhe dorëzanësit e pasurive të poseduara nga banka ose dega e bankës së huaj, një deklaratë për natyrën dhe shumën e detyrimeve të pretenduara të tyre, sipas regjistrave të saj. Në deklaratë cilësohet se çdo kundërshtim depozitohet pranë likuidatorit brenda një muaji dhe u kërkohet klientëve të shërbimeve të arkës kasafortë, si dhe dorëzanësve të pasurive të poseduara nga banka të tërheqin pasuritë e tyre;

bashkëpunon me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për kompensimin e depozitave të siguruara në përputhje me ligjin “Për sigurimin e depozitave”.

11. Çdo pasuri e mbajtur në objektet e bankës ose të degës së bankës së huaj brenda arkave kasafortë dhe që nuk është tërhequr përpara datës së bërë të njohur nga likuidatori, merret në posedim nga ky i fundit, sipas mënyrës së parashikuar nga Banka e Shqipërisë.

12. Çdo mjet financiar i papretenduar dhe i poseduar nga banka ose dega e bankës së huaj, si mbajtëse e dorëzanisë, së bashku me inventarët përkatës, konsiderohen si mjete financiare të papretenduara, që merren në posedim dhe mbahen nga Banka e Shqipërisë, e cila duhet të përpiqet të identifikojë pronarin e vërtetë.

Neni 118

Përgatitja e bilancit nga likuidatori

Likuidatori, menjëherë me emërimin e tij, merr kontrollin mbi bankën duke siguruar aktivet e saj, librat dhe llogaritë e bankës. Ai ka akses të padiskutueshëm të kontrollojë mbi të gjitha aktivet, zyrat dhe librat e bankës.

Brenda tridhjetë ditëve kalendarike, nga data e fillimit të procedurave të likuidimit të bankës, likuidatori bën inventarin e aktiveve dhe të pasurive të bankës, përgatit bilancin dhe raportin sqarues në lidhje me zërat e bilancit të bankës në likuidim.

Bilancin dhe raportin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, likuidatori e paraqet në Bankën e Shqipërisë, e cila përgatit një kopje të përshtatshme për konsultim nga publiku.

Neni 119

Shitja e bankës

1. Likuidatori, jo më vonë se dymbëdhjetë muaj nga data e emërimit, sipas rrethanave dhe afateve të parashikuara në këtë ligj, duhet:

a) të sigurojë kushtet për blerjen e aktiveve specifike nga të tretët dhe të përqendrojë pasivet e veçanta në një ose disa banka;

b) të likuidojë aktivet e bankës, siç parashikohet në këtë kre, me kusht që Banka e Shqipërisë të miratojë ose të refuzojë kushtet e propozuara të shitjes së bankës; ose

c) të shesë bankën.

2. Likuidatori bashkëpunon me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për likudimin e depozituesve të vegjël deri në shumat e përcaktuara nga ligji “ Për sigurimin e depozitave”.

3. Likuidatori ushtron veprimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kur sipas gjykimit të tij janë mundësitë për grumbullimin e shumave më të mëdha të aktiveve të bankës ose degës së bankës së huaj apo që mbrojnë të drejtat e depozituesve dhe të kreditorëve të tjerë.

4. Për realizimin e shitjes së bankës, sipas pikës 1 shkronja “c” të këtij neni ose për sigurimin e kushteve për blerjen e të gjitha aktiveve kryesore nga të tretët, si dhe të përqendrimit të të gjitha pasiveve kryesore në një ose disa banka, sipas pikës 1 shkronja “a” të këtij neni, likuidatori ka të drejtë të lejojë reduktimin e vlerave të pasivit aq sa, sipas gjykimit të tij, asnjë depozitues ose kreditor tjetër të mund të marrë më pak sesa mund të merrte në likuidim.

5. Për përcaktimin e shumës së aktiveve, që mund të sigurohen nga shitja e aktiveve të bankës ose të degës së bankës së huaj, likuidatori duhet:

a) të vlerësojë alternativat e vlerave të çastit, duke përdorur përqindje skontimi realiste; dhe

b) të dokumentojë vlerësimin dhe parashikimin, mbi të cilin vlerësimi është i bazuar, duke përfshirë çdo parashikim në lidhje me përqindjen e interesave, përqindjen e aktiveve të kthyeshme, inflacionin, koston e zotërimit (mirëmbajtja) të aktiveve dhe pagimin e detyrimeve të kushtëzuara.

Neni 120

Detyrime të pretenduara

1. Të gjitha detyrimet e pretenduara për dhe në lidhje me paaftësinë paguese të bankës ose të bankës në likuidim, përpara likuidatorit ose Bankës së Shqipërisë, parashtrohen në përputhje me dispozitat e këtij kreu.

2. Mbi bazën e rrethanave të emërimit të likuidatorit, kanë të drejtë të fillojnë procedurat ligjore në gjykatën e apelit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të tij, për të kërkuar ndërprerjen e procedurave të likuidimit, këto subjekte:

një ose më shumë aksionerë të bankës që disponojnë në total jo më pak se 25 për qind të çdo kategorie të aksioneve me të drejtë vote në bankë;

çdo person ose grup personash që zotëron të paktën një të katërtën e shumës totale të depozitave monetare;

kreditorët që përbëjnë të paktën një të tretën në vlerë të totalit të detyrimeve të pretenduara nga kreditorë të tjerë, duke përjashtuar depozituesit.

3. Gjykata zhvillon seancën brenda dhjetë ditëve nga paraqitja e kërkesëpadisë nga pala paditëse. Brenda njëzet ditëve nga seanca përgatitore, gjykata vendos për kërkesëpadinë e bërë vetëm nëse:

a) Banka e Shqipërisë ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe të pakujdesshme për vendosjen e likuidimit, sipas rrethanave të faktit dhe dispozitave të këtij ligji për likuidimin e detyrueshëm të bankave;

b) Banka e Shqipërisë, likuidatori dhe nëpunësit profesionistë të emëruar për të ndihmuar likuidatorin janë përgjegjës ose jo për dëmet e shkaktuara nga veprimet ose mosveprimet e kryera, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, që përcaktojnë mënyrën e ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të procesit të likuidimit, përveç rasteve kur veprimet ose mosveprimet e tilla janë qëllimisht të gabuara.

4. Në rast se gjykata vendos që Banka e Shqipërisë ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe të pakujdesshme për vendosjen e likuidimit, e vetmja masë dëmshpërblimi që vendoset nga gjykata është dëmi monetar që Banka e Shqipërisë duhet të paguajë.

5. Bankës së Shqipërisë i njihet e drejta e rishqyrtimit të vendimit të revokimit dhe e ridhënies së licencës. Në rast se gjykata vendos që Banka e Shqipërisë nuk ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe të pakujdesshme për vendosjen e likuidimit, padia refuzohet.

6. Pavarësisht nga procesi i shqyrtimit gjyqësor, sipas këtij neni, procesi i likuidimit të detyruar të Bankës së Shqipërisë zbatohet pa kufizim deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

7. Brenda dy muajve pas datës së fundit të njoftimit, të përcaktuar në nenin 117 pika 10 shkronja “b” të këtij ligji, që lidhet me detyrimet e pretenduara, likuidatori:

refuzon çdo detyrim të pretenduar, në rast se dyshon për vlefshmërinë e tij;

përcakton shumën, në rast se ka, që i detyrohet çdo depozituesi të njohur dhe kreditorëve të tjerë, si dhe detyrimet e pretenduara preferuese, sipas dispozitave të këtij ligji;

përgatit për regjistrim në Bankën e Shqipërisë një strukturë për detyrimet e pretenduara të pranueshme;

ç) njofton çdo person, detyrimi ndaj të cilit nuk është pranuar plotësisht, duke publikuar një herë në çdo tre javë kronologjike, në një ose disa gazeta kombëtare, një njoftim për datën dhe vendin, në të cilin struktura e detyrimeve të pretenduara është e vlefshme për konsultim nga publiku, si dhe datën brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e publikimit për herë të tretë të njoftimit, në të cilën likuidatori regjistron strukturën e detyrimeve të pretenduara;

bashkëpunon me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për kompensimin e depozitave të siguruara, në përputhje me ligjin “Për sigurimin e depozitave”.

8. Brenda njëzet ditëve pas regjistrimit të strukturës së detyrimeve të pretenduara, sipas pikës 7 shkronja “c” të këtij neni, çdo depozitues, kreditor tjetër ose një apo më shumë aksionerë, që disponojnë në total jo më pak se 10 për qind të çdo kategorie të aksioneve me të drejtë vote të bankës, kanë të drejtë të paraqesin pranë Bankës së Shqipërisë kundërshtimet në lidhje me regjistrimin e detyrimeve të prapambetura. Për çdo kundërshtim të paraqitur, Banka e Shqipërisë vendos brenda 1 muaji nga regjistrimi i ankesës.

9. Në rast se kundërshtimi është pranuar, likuidatori modifikon dhe përmirëson strukturën e detyrimeve të pretenduara ose veprimet e propozuara për shlyerjen e detyrimeve.

10. Pas regjistrimit të strukturës, likuidatori, herë pas here, ka të drejtë t'i përmbushë pjesërisht detyrimet e pretendimeve të parefuzuara ose të pretendimeve të pranuara, me kusht që të jetë mbajtur një rezervë e mjaftueshme për pagimin e detyrimeve të pretenduara, por të refuzuara.

Neni 121
Radha e shlyerjes së detyrimeve

Në rast të likuidimit të bankës ose degës së bankës së huaj, detyrimet e pretenduara, të siguruara me mjete të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve, shlyhen sipas vetë kushteve të parashikuara për këtë qëllim, kurse detyrimet për pretendimet e tjera të pranuara shlyhen me preferencë ndaj të gjitha detyrimeve të tjera, sipas radhës së detyrimeve të pretenduara si më poshtë:

a) shpenzimet e domosdoshme dhe të arsyeshme të bëra nga likuiduesi dhe Banka e Shqipërisë në zbatim të dispozitave të këtij kreu;

b) kreditorët e kredive të reja të dhëna bankës ose degës së bankës së huaj pas zgjedhjes dhe emërimit të likuidatorit;

c) pretendimet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si dhe detyrimet e pretenduara nga depozituesit e vegjël deri në masën e parashikuar në ligjin "Për sigurimin e depozitave";

ç) depozituesve që nuk kanë përfituar sipas shkronjës "c" të kësaj pike;

d) detyrimet e tjera të pretenduara kundrejt bankës ose degës së bankës së huaj.

Çdo detyrim tjetër i pretenduar, i vlefshëm dhe i mbetur pa u zgjidhur, për shkak të mosregjistrimit brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e kundërshtimeve, sipas pikës 8 të nenit 120 të këtij ligji, paguhet mbi bazën e përqindjes së përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të pretenduara, të siguruara me mjete të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve dhe të detyrimeve të pretenduara të regjistruara.

Detyrimi i pretenduar, i siguruar me mjete të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve, shlyhet deri në masën e sigurimit të tij në datën e regjistrimit të tij në strukturën e detyrimeve të pretenduara e të pranuara.

Çdo aktiv i mbetur pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të pretenduara shpërndahet midis aksionerëve në raport me të drejtat dhe pjesëmarrjen e secilit në kapitalin e bankës ose degës së bankës së huaj.

Në rast se shuma e mbetur për shlyerjen e detyrimeve të pretenduara të secilit grup të renditur në këtë nen është e pamjaftueshme për të kryer pagesën e plotë të tyre, atëherë ajo bëhet proporcionale me shumat që paguhen.

Neni 122
Raportimi në Bankën e Shqipërisë

1. Likuidatori i raporton menjëherë Bankës së Shqipërisë për përfundimin e shpërndarjes së të gjitha aktiveve të bankës ose të degës së bankës së huaj gjatë procesit të likuidimit.

2. Banka e Shqipërisë dhe likuidatori lirohen nga çdo përgjegjësi tjetër, në lidhje me likuidimin e bankës ose degës së bankës së huaj, sapo Banka e Shqipërisë të miratojë këtë raport.

3. Likuidatori raporton çdo muaj në Bankën e Shqipërisë për ecurinë e procesit të likuidimit. Këto raporte përmbajnë informacionin për totalin e shumës së detyrimeve të pretenduara ndaj bankës, totalin e shumës së aktiveve të bankës ose degës së bankës së huaj që janë shitur dhe parashikimin e të ardhurave nga shitja e aktiveve.

Neni 123
Të përgjithshme

Nëpunësit profesionistë, të caktuar dhe të emëruar nga likuidatori për ndihmë, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë kre dhe në varësi të kërkesave dhe të kushteve të shërbimit, nuk shpërblehen më shumë se nëpunësit e bankës për të njëjtat shërbime, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë ka autorizuar pagesën e shumave më të larta. Banka e Shqipërisë e jep këtë autorizim, kur arrin në përfundimin se pagesa e shumave më të larta është mëse e domosdoshme për të rekrutuar dhe mbajtur personelin e nevojshëm.

KREU VIII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 124
Mbrojtja e klientit

Banka ose dega e bankës së huaj nënshkruan marrëveshje ose lidh kontratë me klientin e saj për shërbimin që ajo merr përsipër të kryejë.

Para nënshkrimit të marrveshjes ose kontratës, banka ose dega e bankës së huaj i paraqet klientit të saj të gjitha kushtet e marrëveshjes ose kontratës, duke sqaruar të drejtat dhe detyrimet e palëve nënshkruese të marrëveshjes ose kontratës.

Banka ose dega e bankës së huaj informon klientin për kushtet e shërbimeve që ajo ofron në një vend të

përshtatshëm brenda lokalit ku zhvillohet veprimtaria bankare ose financiare.

Banka ose dega e bankës së huaj shpall ose informon paraprakisht klientët e saj lidhur me kushtet e dhënies së kredisë për:

përqindjet vjetore aktuale të kredive të rregullta dhe të kredive me probleme;

b) metodat e llogaritjes së interesave;

c) shumën e kryegjësë dhe interesit për t'u paguar për shumën përkatëse të kredisë, periudhat e ripagimit, numrin dhe shumat e kësteve;

ç) kushtet e depozitave monetare në cash, që përdoren si garanci për dhënien e kredisë;

d) mundësitë dhe kushtet për mbulimin e detyrimit të kredisë me depozitën monetare në cash, të vendosur si garanci për kredinë;

dh) llojet e kolateraleve;

e) kushte të tjera.

Banka informon klientin për kushtet e pranimit të depozitave monetare në lidhje me:

përqindjet aktuale të interesave;

b) metodat e llogaritjes së interesave;

c) kushtet kur përqindjet e interesave ndryshojnë;

ç) përqindja efektive e interesit, në rastin e prishjes para afatit të depozitës monetare;

d) informacionin bazë për sigurimin e depozitave monetare, sipas dispozitave të ligjit "Për sigurimin e depozitave".

Banka njofton klientët e saj, sipas mënyrës së rënë dakord më parë, por jo më rrallë se një herë në vit, për gjendjen të drejtave dhe detyrimeve të tyre ndaj bankës.

Banka njofton klientët e saj, para aplikimit të tyre, në rastin kur përqindjet e interesave janë të ndryshueshme, nëpërmjet organeve të mjeteve të komunikimit masiv.

Neni 125

Ruajtja e sekretit të informacionit për klientin

Banka ose dega e bankës së huaj ruan sekretin e informacionit për klientin dhe nuk e përdor atë për përfitime vetjake ose për të tretët, të cilëve u shërbejnë ose u kanë shërbyer, në përputhje me nenin 91 dhe kriteret e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë me akt nënligjor.

Detyrimi i bankës ose i degës së bankës së huaj për ruajtjen e sekretit të informacionit për klientin, sipas pikës 1 të këtij neni, është pjesë e marrëveshjes apo kontratës së përcaktuar në nenin 124 pika 2 të këtij ligji.

Neni 126

Subjektet financiare jobanka

Subjektet financiare jobanka krijohen dhe organizohen sipas ligjit "Për shoqëritë tregtare".

Banka e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë specifikat e veprimtarisë financiare që ushtrojnë këto subjekte, me akt nënligjor përcakton rregullat e licencimit, mbikëqyrjes dhe funksionimit të tyre, përveç rasteve kur ligji parashikon shprehimisht që kërkesat e parashikuara në të zbatohen edhe për këto subjekte.

Banka e Shqipërisë realizon mbikëqyrjen, nëse e gjykon të arsyeshme, të subjekteve financiare jobankare nëpërmjet procesit të licencimit, rregullimit, analizës dhe mbikëqyrjes në vend.

Subjektet financiare jobanka raportojnë në Bankën e Shqipërisë informacionin e kërkuar prej saj, sipas llojit, mënyrës, periodicitetit dhe afateve të përcaktuara prej saj me akt nënligjor.

Neni 127

Regjistri i Kredive

Banka e Shqipërisë mban Regjistrin e Kredive, i cili përmban informacion në lidhje me kreditë që bankat dhe degët e bankave të huaja u japin klientëve të tyre.

Bankat dhe degët e bankave të huaja raportojnë në Bankën e Shqipërisë informacionin e kërkuar nga kjo e fundit për qëllim të Regjistrit të Kredive.

Bankat dhe degët e bankave të huaja raportojnë në Bankën e Shqipërisë, për qëllim të Regjistrit të Kredive, informacionin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni për të gjitha kreditë e pashlyera, të lëvruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Lloji i informacionit, mënyra, periodiciteti dhe afatet e raportimit të përshkruar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni përcaktohen me akt nënligjor nga Banka e Shqipërisë.

Bankat dhe degët e bankave të huaja kanë të drejtë të kërkojnë dhe të përdorin informacionin e mbajtur në Regjistrin e Kredive, sipas procedurës së përcaktuar me akt nënligjor nga Banka e Shqipërisë.

Ruajtja dhe përdorimi i informacionit të mbajtur në Regjistrin e Kredive bëhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen dhe trajtimin e të dhënave personale, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

Bankat dhe degët e bankave të huaja mund të shkëmbejnë informacion në lidhje me kreditë që u japin klientëve, mbi bazën e një marrëveshjeje midis tyre dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit tjetër në fuqi.

Banka e Shqipërisë, me akt nënligjor, mund të detyrojë edhe subjekte të tjera të këtij ligji të raportojnë për qëllim të Regjistrit të Kredive, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Neni 128

Regjistri i subjekteve të licencuara

1. Banka e Shqipërisë mban një regjistër për konsultim nga publiku, në të cilin, për të gjitha subjektet e licencuara prej saj, regjistrohen:

a) emri;

b) adresa e selisë, si dhe e degës apo agjencisë, nëse ka;

c) emrat e administratorëve;

ç) lista e aksionerëve, kur është e zbatueshme.

2. Në regjistër mbahen gjithashtu:

a) kopje të aktit të themelimit dhe të statutit;

b) kopje të licencës së lëshuar nga Banka e Shqipërisë;

c) kopje të vendimeve të regjistrimit të gjykatë.

3. Një kopje e këtij regjistri mbahet për konsultim nga publiku në çdo përfaqësi rajonale të Bankës së Shqipërisë.

Dokumentet që kanë të bëjnë me subjektet, licenca e të cilave është revokuar, hiqen nga regjistri. Një listë e këtyre subjekteve mbahet në regjistër, duke cilësuar se licencat e tyre janë revokuar.

Neni 129

Sistemet elektronike të pagesave

Banka e Shqipërisë dhe bankat ose degët e bankave të huaja mund të marrin pjesë në sisteme elektronike pagesash, në përputhje me këtë nen dhe me akte të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Dërgimi në formë elektronike i një urdhri për transfertë konsiderohet njëlloj i vlefshëm me dërgimin e urdhrit me shkrim. Urdhër quhet instruksioni për transferimin e fondeve në favor të përfituesit, me kusht që të jetë dhënë nga një urdhërues dhe të jetë pranuar nga një institucion ekzekutues. Në rast të transfertave jo cash, institucion ekzekutues mund të jetë vetëm Banka e Shqipërisë, një bankë ose degë e bankave të huaja.

Një urdhër për një sistem elektronik pagesash nënkupton çdo instruksion të dhënë në formë elektronike nga një pjesëmarrës në sistemin e pagesave, për transferimin e fondeve, si dhe për ekzekutimin e shlyerjes, në përputhje me rregullat e sistemit.

Pas çastit të pranimit nga sistemi të një urdhri, në përputhje me rregullat e sistemit, urdhri nuk mund të revokohet as nga një pjesëmarrës sistemi dhe as nga ndonjë palë e tretë. Ekzekutimi i një urdhri të pranuar nga sistemi nuk mund të ndalohet me ndonjë mënyrë tjetër.

Shlyerje quhet transferimi i fondeve ndërmjet llogarive që bankat ose degët e bankave të huaja mbajnë pranë Bankës së Shqipërisë. Shlyerja e pagesës kryhet vetëm në sistemin e shlyerjes bruto në kohë reale.

Veprimtaria e sistemeve të pagesave dhe i pjesëmarrësve në to rregullohet nëpërmjet akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë, si dhe marrëveshjeve të lidhura mes Bankës së Shqipërisë dhe subjekteve që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 130

Taksat dhe tatimet

Banka paguan tatime dhe taksa të parashikuara me ligj.

Neni 131

Marrëdhëniet e bankës ose degës së bankës së huaj me persona të lidhur me të

Banka ose dega e bankës së huaj nuk ushtron veprimtari bankare ose financiare me dhe në përfitim të personave të lidhur me të, në rast se veprimtaria mund të përfundohet me kushte dhe afate më të favorshme se ato që zbatohen për klientët e zakonshëm të bankës.

Banka ose dega e bankës së huaj nuk jep kredi për dhe në përfitim të personave të lidhur me të, nëse totali i tepricës së të gjitha kredive të dhëna nga banka ose dega e bankës së huaj, për persona të lidhur me të, kalon shumën e kapitalit rregullator të përcaktuar me akt nënligjor nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kufizimet dhe kushtet e kredive të bankës ose degës së bankës së huaj për personat e lidhur me të.

Neni 132

Mbrojtja ligjore gjatë ushtrimit të detyrës

1. Banka e Shqipërisë, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, administratorët dhe çdo punonjës i saj nuk janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve nga veprimet ose mosveprimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës funksionale dhe përmbushjes së përgjegjësive të tyre ligjore, të përcaktuara me ligjin organik të Bankës ë Shqipërisë dhe me këtë ligj.
2. Punonjësit e Bankës së Shqipërisë, përjashtimisht, mund të përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë ose juridikë privatë, vetëm kur provohet se ata kanë vepruar me keqbesim.
3. Në rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, Banka e Shqipërisë, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit që ka paguar.
4. Në rastet kur punonjësi i paditur, në bazë të pikës 2 të këtij neni, deklarohet i pafajshëm me vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente, Banka e Shqipërisë është e detyruar t'i rimbursojë atij shumën e plotë të shpenzimeve që ai ka kryer për të realizuar përfaqësimin dhe mbrojtjen e tij ligjore.
5. Dispozitat e ligjit nr.8510, datë 15.7.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore" nuk zbatohen për të përcaktuar përgjegjësinë jashtëkontraktore të Bankës së Shqipërisë, si dhe të organeve apo punonjësve të saj.

Neni 133

Vendimet si tituj ekzekutivë

Aktet administrative të Bankës së Shqipërisë, të nxjerra në zbatim të këtij ligji dhe që parashikojnë masa ndëshkimore, të cilat vendosin detyrime financiare, janë tituj ekzekutivë, për ekzekutimin e të cilave ngarkohet zyra e përmbarimit.

Neni 134

Dispozitë kalimtare

1. Subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohen si të licencuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë t'i kërkojë subjektit të paraqesë informacion shtesë nëse, sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë, informacioni i paraqitur në kohën e marrjes së licencës nuk është i plotë ose i mjaftueshëm.

3. Për kërkesat e paraqitura në Bankën e Shqipërisë për marrjen e licencës për të ushtruar veprimtari bankare, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe subjekteve, të cilave u është komunikuar me shkrim nga Banka e Shqipërisë se kanë plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ligji nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", nuk zbatohen dispozitat e këtij ligji, por vazhdojnë të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

4. Të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", zbatohen për aq sa ato nuk bien në kundërshtim më këtë ligj, deri në zëvendësimin e tyre me akte të tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 135

Dispozitë shfuqizuese

Ligji nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" shfuqizohet.

Neni 136

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 2007.

Shpallur me dekretin nr.5178, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare
ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark",
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	**PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)…….....**	**1500**
2.	**PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) …….....**	**600**
3.	**PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....**	**1300**
4.	**PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT…….....**	**500**

Botime të reja

1	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…....….....**	**1000**
2	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…....….....**	**500**
3	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)……..….....**	**1000**
4	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)……..….....**	**500**
5	**PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË…….....**	**1000**
6	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR…….**	**800**
7	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET……....….....**	**500**
8	**PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)……**	**1000**
9	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE…….....**	**500**

Doli nga shtypi më 18.1.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2007

Çmimi 62 lekë